



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 470 Akti

Nr. 471 Vendimi  
Tiranë, më 3.11.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Alma Faskaj** Kryesuese  
**Genta Tafa (Bungo)** Relatore  
**Lulzim Hamitaj** Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 1.11.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Endrit Bimi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Endrit Bimi, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Endrit Bimi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Alma Faskaj dhe Lulzim Hamitaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 19.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Alma Faskaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Endrit Bimi.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Endrit Bimi, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**10.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Endrit Bimi. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *nuk ka dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimin financiar nga znj. L.K (bashkëjetuesja);*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**11.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Endrit Bimi.

**12.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**13.** Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

**14.** Trupi gjykues, në praninë *online* edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 15.10.2021 vendosi: (i) në mënyrë unanime, të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Endrit Bimi, bazuar në relatimin e bërë nga relatori i çështjes dhe me shumicë votash<sup>4</sup> të miratojë rezultatet e hetimit siç janë; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**15.** Subjekti i rivlerësimit, po në të njëjtën datë, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 18.10.2021, ndërsa në datën 25.10.2021 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

---

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2018.

<sup>2</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.4.2021, të KDZH-së.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2021.

<sup>4</sup> Sipas procesverbalit të mbledhjes.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore<sup>5</sup>.

## II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë me *e-mail* në datën 26.10.2021.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 1.11.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic.

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Endrit Bimi, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Endrit Bimi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime, kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

## IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës dhe pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>6</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në

<sup>5</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 26.10.2021.

<sup>6</sup> “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

**23.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

**23.1.** Subjekti është emëruar në detyrë në datën 4.10.2006, si dhe ka deklaruar fillimin e bashkëjetesës me znj. L. K në vitin 2013.

**23.2.** Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 23.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

### **24. Depozitë bankare në vlerën 8,300 USD në “Raiffeisen Bank”<sup>7</sup>**

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** të ardhurat nga puna me kohë të pjesshme në fondacionin “Për edukimin ekonomik të të rinjve”, plus interesat bankare.

#### **Hetimi<sup>8</sup>/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

**24.1.** Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, të “Raiffeisen Bank” ka rezultuar se subjekti, në datën 23.3.2005 ka çelur dy llogari bankare në vlerën 3,000 USD secila. Këto dy depozita kanë shërbyer për krijimin e një depozite të vetme në datën 12.7.2006<sup>9</sup>, në shumën 6,223.67 USD.

Nga hetimi ka rezultuar se në datën 23.2.2007 subjekti ka depozituar në llogarinë nr. \*\*\*-USD-\*\*\* në “Raiffeisen Bank” shumën 1,625.67 USD<sup>10</sup>, me përshkrimin “Derdhje në depozitë fleksi” dhe gjendja e depozitës në këtë datë ka rezultuar të jetë në shumën 7,836 USD.

Kjo shumë, së bashku me interesat përgjatë viteve 2009 - 2016, është investuar në depozita periodike. Në datën 23.1.2017 kjo depozitë ka rezultuar me principal 8,022 USD.

Në datën 12.5.2017 subjekti ka transferuar shumën 8,314.57 USD në llogari të shtetasit A. S. K (babai i bashkëjetueses së subjektit) me përshkrimin “Kalim babait të bashkëjetueses”.

Subjekti është pyetur mbi arsyen e transferimit të këtyre fondeve, i cili, në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2 ka deklaruar: “*Arsyeja e transfertës është dhënie huaje ne favor të z. A. K, pa interes, në mirëbesim, pa kontratë, dhe shumat e transferuara janë përdorur të*

<sup>7</sup> Subjekti ka bashkëlidhur: (i) nxjerrje llogarie datë 12.10.2016; dhe (ii) shkresë datë 20.12.2016, e USAID Albania.

<sup>8</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar “Raiffeisen Bank” dhe shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2020.

<sup>9</sup> Subjekti ka deklaruar në DVP/2006 depozitë me gjendje në vlerën 6,000 USD.

<sup>10</sup> Në DVP/2007 subjekti ka deklaruar si shtesë fondesh në depozitë shumën 1,625.67 USD.

gjitha për blerjen e një apartamenti në vitin 2017. Ky apartament nuk përdoret nga unë. Ky apartament përdoret nga z. A. K”.

**24.2.** Si burim për krijimin e kësaj depozite subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhurat nga punësimi i tij me kohë të pjesshme pranë fondacionit “Për edukimin ekonomik të të rinjve”, mbështetur dhe financuar nga USAID-i dhe interesat bankare. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* shkresën e USAID-it<sup>11</sup>, sipas së cilës nuk mund të konfirmohet punësimi i tij në projektin e financuar nga kjo agjenci. Nga verifikimi i deklaratave periodike rezulton se subjekti ka deklaruar në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2006 të ardhura në shumën 8,000 USD nga punësimi i tij me kohë të pjesshme pranë fondacionit “Për edukimin ekonomik të të rinjve”, për një periudhë 3.5-vjeçare.

**24.3.** Me qëllim verifikimin e të ardhurave të përfituara nga punësimi i deklaruar nga subjekti, Komisioni i është drejtuar me shkresë organizatës “J.A.A”<sup>12</sup>, ku në përgjigje të saj, kjo agjenci sqaron se nuk disponon dokumentacion apo të dhëna për këtë entitet.

**24.3.1.** Nga analiza financiare më poshtë rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e depozitës.

**Tabela nr. 1**

	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004	Kumulative, datë 23.3.2005
<b>Pasuria</b>	-	-	-	-	-	<b>658,977.16</b>
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	-	-	-	-	-	658,977.16
<b>Detyrime</b>	0	0	0	0	0	<b>0.00</b>
<b>Pasuri neto</b>	-	-	-	-	-	<b>658,977.16</b>
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	38,948.00	150,498.00	161,430.00	391,617.00	328,447.00	<b>1,187,265.00</b>
Të ardhura	38,948.00	150,498.00	161,430.00	391,617.00	328,447.00	1,187,265.00
<b>Shpenzime</b>	-	-	-	-	-	<b>52,692.20</b>
Shpenzime jetike	-	-	-	-	-	-
Udhëtime jashtë vendit ( <i>TIMS</i> )	0	0	0	0	0	52,692.20
<b>Mundësia për kursim</b>	38,948.00	150,498.00	161,430.00	391,617.00	328,447.00	<b>475,595.64</b>

Analiza financiare është bazuar në elementet e mëposhtme:

- i. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti dhe përgjigjeve të tij në pyetësor, në analizën financiare janë konsideruar të ardhura të dokumentuara, si vijon:
  - të ardhurat nga paga si jurist në ISPU dhe në Ministrinë e Ekonomisë për vitet 2000-2004, në vlerën 815,620 lekë;
  - të ardhurat si student në Shkollën e Magjistraturës për periudhën 2004 – 23.3.2005, në vlerën 232,650 lekë;
  - nuk janë konsideruar të ardhurat nga puna si koordinator me kohë të pjesshme për rreth 3.5 vjet në fondacionin “Për edukimin ekonomik të të rinjve”, në vlerën 7,500 USD, të

<sup>11</sup> Kërkesë për informacion nr. \*\*\*prot., datë 31.10.2016, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dërguar USAID-it dhe shkresë kthim përgjigje datë 20.12.2016.

<sup>12</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021, drejtuar “J.A.A” dhe shkresë kthim përgjigje datë 9.6.2021.

cilat nuk janë përfshirë në analizë, pasi subjekti nuk provoi me dokumentacion punësimin pranë këtij entiteti.

- ii. Nuk janë konsideruar shpenzimet jetike, bazuar në deklaratimet e subjektit në pyetësonin nr. 2, ku ai ka deklaruar se deri në fund të vitit 2006 (kohë kur ka filluar detyrën e prokurorit) shpenzimet e tij jetike vazhdonin të mbuloreshin prej prindërve, ndërsa të ardhurat e tij kurseheshin në llogarinë e tij, të cilat janë kursime që ka deklaruar në deklaratën fillestare.

Në përgjigje të pyetësonit nr. 1, datë 5.5.2021, subjekti ka deklaruar: *“Kam jetuar që nga lindja në të njëjtin apartament me prindërit dhe vëllain. Nga muaji shkurt i vitit 2001 vëllai ka emigruar. Marrëdhënia jonë ka qenë dhe është marrëdhënie prind-fëmijë, sipas traditave e zakoneve të vendit tonë. Shpenzimet për jetesë dhe përkujdesje kanë qenë nën përgjegjësinë prindërore e me sigurimin e të ardhurave nga vëllai dhe unë është kontribuar për nevojat tona jetike në familje”.*

Në përgjigje të pyetësonit nr. 2, datë 22.6.2021 subjekti ka deklaruar: *“Sqaroj se deri në fund të vitit 2006 (kohë kur kam filluar detyrën e prokurorit) shpenzimet e mia jetike vazhdonin të mbuloreshin prej prindërve, ndërsa të ardhurat e mia kurseheshin për llogarinë time, që janë kursimet që kam deklaruar në deklaratën fillestare”.*

Komisioni ka kryer hetimin mbi mundësitë financiare të prindërve të subjektit për të përballuar shpenzimet jetike të tij deri në marrjen e detyrës në datën 4.10.2006.

**Tabela nr. 2** – analiza financiare e familjes prindërore të z. Endrit Bimi

	<b>Kumulative, periudha 1989 – 4.10.2006</b>
<b>Pasuria</b>	<b>0.00</b>
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	0.00
<b>Detyrime</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuri neto</b>	<b>0.00</b>
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	<b>5,059,080.92</b>
Të ardhura të subjektit	0.00
Të ardhura të babait	1,076,330.17
Të ardhura të nënës	2,571,266.75
Të ardhura të vëllait nga puna në Shqipëri	711,484.00
Të ardhurat nga puna në emigracion	700,000.00
<b>Shpenzime</b>	<b>3,128,893.50</b>
<b>Shpenzime jetike</b>	<b>3,128,893.50</b>
<b>Mundësia për kursim</b>	<b>1,930,187.42</b>

Në analizë janë konsideruar:

- i. Të ardhurat e prindërve të subjektit, shtetasi E.B<sup>13</sup> në shumën 1,076,330.17 lekë dhe shtetasja Sh. B<sup>14</sup> në shumën 2,571,266.75 lekë.
- ii. Të ardhurat e vëllait të subjektit M. B<sup>15</sup> nga punësimi në Shqipëri, për periudhën 1997 – 2000, në shumën 711,484 lekë.
- iii. Të ardhurat e vëllait të subjektit M.B nga punësimi në shtetin kanadez, prej të cilave u ka dërguar prindërve shumën 700,000 lekë<sup>16</sup>, e cila ka shërbyer si burim për krijimin e depozitës në vitin 2004.

<sup>13</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2020, e ISSH-së Tiranë.

<sup>14</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2020, e ISSH-së Tiranë.

<sup>15</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2020, nga Drejtoria e Arkivit Qendror Tiranë.

<sup>16</sup> Vërtetim mbi tatimin e të ardhurave, lëshuar nga Agjencia e të Ardhurave Kanada për vitet tatimore 2001, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2007, të cilat janë përlllogaritur në shumën 6,674,709.90 lekë.

- iv. Të ardhurat e subjektit nuk janë konsideruar në analizën financiare, pasi kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitave bankare të deklaruara prej tij.
- v. Shpenzimet jetike për periudhën 1989 – 2000 janë llogaritur për 4 persona. Në muajin shkurt vëllai i subjektit M. B është larguar në emigracion dhe për këtë arsye shpenzimet jetike për periudhën 2001 – 4.10.2006 janë konsideruar për 3 persona.

Nga analiza financiare rezulton se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet jetike të subjektit për periudhën para marrjes së detyrës.

Në përfundim në lidhje me këtë pasuri, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite të krijuar para fillimit të detyrës, ndërkohë që Komisioni ka konstatuar pasaktësi në burimin e deklaruar të kësaj depozite, duke qenë se subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion provues për të ardhurat e krijuara nga puna me kohë të pjesshme në fondacionin “Për edukimin ekonomik të të rinjve”. Në lidhje me këtë konstatim subjektit, me dërgimin e rezultateve të hetimit, iu kërkuan shpjegime.

**24.3.2.** Në parashtrimet e tij, subjekti u ka qëndruar shpjegimeve dhe provave të paraqitura më parë pranë Komisionit gjatë hetimit administrativ. Ai ka sqaruar se të ardhurat e përfituara nga fondacioni i ka deklaruar që në deklaratën fillestare të vitit 2006 në ILDKPKI, çka, sipas tij, tregon se ka qenë transparent me të ardhurat dhe burimin e tyre. Ky deklaram, sipas subjektit, përbën provë në kuptim të paragrafit 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka deklaruar se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar dokumentet financiare për të ardhurat e përfituara nga fondacioni dhe se ka paraqitur të gjitha provat që vërtetojnë punësimin dhe pagën e tij të tatuuar në burim, duke u gjendur kështu në kushtet e parashikuara në paragrafin 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti, së bashku me rezultatet e hetimit, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- i. Kopje të faqes së gazetës “B”, ku citohet emri i subjektit si koordinator i projektit në fondacion.
- ii. Përgjigjen e USAID Albania, nga e cila rezulton se informacioni për punonjësit dhe faturat për pagën e tyre ruhen për një afat 6-vjeçar dhe më pas asgjësohen.
- iii. Deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 17.2.2020, e shtetas L.M, ish-drejtoreshë ekzekutive e fondacionit “Për edukimin ekonomik të të rinjve”, në përmbajtje të së cilës deklaroi se *me përgjegjësi dhe me sa mban mend gjatë periudhës 2002 – 2004 pranë këtij fondacioni ka qenë i punësuar z. E. B, në pozicionin e koordinatorit për projektin “B.L”, projekt i financuar nga USAID-i. Ai ka qenë i angazhuar në këtë projekt nëpërmjet kontratës së shërbimit dhe është paguar me honorare, të cilat shkonin në masën 200 USD/muaj. Tatimi mbi të ardhurat është mbajtur në burim.*
- iv. Pjesë nga libri “E drejta dhe biznesi”, botuar nga fondacioni “Për edukimin ekonomik të të rinjve”, parathënia e të cilit është shkruar nga subjekti i rivlerësimit.

**24.3.3.** Komisioni analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, nga të cilat rezultoi se:

- i. Subjekti ka provuar me anë të dokumentacionit të paraqitur faktin se ka punuar me kohë të pjesshme pranë fondacionit “Për edukimin ekonomik të të rinjve” në periudhën 2002 – 2004.
- ii. Honoraret, pagesat për kontrata e shërbimit apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre nuk përfshihen në pagën mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Pagesa për këtë punë i nënshtrohej vetëm detyrimit tatimor që mbahej në burim të të ardhurave<sup>17</sup>. Agjent tatimor për këtë lloj tatimi ligji ka përcaktuar punëdhënësin dhe në asnjë rast

<sup>17</sup> Ligj nr. 7786, datë 27.1.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”.



punëmarrësin. Në këto kushte, subjekti nuk ka pasur detyrimin ligjor të kontrollonte pagesën e tatimit.

- iii. Subjekti, gjatë kësaj periudhe, nuk ka qenë subjekt rivlerësimi, rrethanë e cila duhet të merret në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin tërësor të njohjes së shumës 7,500 USD si e ardhur nga punësimi i tij në fondacion.
- iv. Pas fillimit të detyrës, në deklarin e kryer për herë të parë në vitin 2006, subjekti ka deklaruar krijimin e depozitës me të njëjtin burim si në deklaratën *Vetting*. Komisioni mban në vëmendje pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilës deklarinet e interesave private dhe pasurore, të paraqitur më parë në ILDKPKI, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson të marrë në konsideratë dhe të përfshijë në analizën financiare shumën e deklaruar nga subjekti, si të përfituar nga puna e tij me kohë të pjesshme pranë fondacionit “Për edukimin ekonomik të të rinjve”, pasi:

- a) kjo shumë është deklaruar në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2006;
- b) kjo shumë është krijuar para fillimit të detyrës së subjektit;
- c) subjekti ka bërë të gjitha përpjekjet për të siguruar informacionin lidhur me punësimin e tij pranë këtij fondacioni, duke i provuar këto përpjekje, në përputhje me nenin 32/2 të ligjit nr. 84/2016;
- d) USAID Albania ka deklaruar se informacioni për punonjësit dhe faturat për pagën e tyre ruhen për një afat 6-vjeçar dhe më pas asgjësohen.

Komisioni ka kryer analizën financiare për mundësinë e subjektit për krijimin e depozitës në vlerën 8,300 USD, duke përfshirë edhe të ardhurat e tij nga punësimi pranë fondacionit “Për edukimin ekonomik të të rinjve” në periudhën 2002 – 2004.

**Tabela nr. 3**

	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004	Datë 23.3.2005	Kumulative, datë 23.3.2005
<b>Pasuria</b>	0	0	0	0	0	0	<b>658,977.16</b>
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	0	0	0	0	0	0	658,977.16
<b>Detyrime</b>	0	0	0	0	0	0	<b>0</b>
<b>Pasuri neto</b>	0	0	0	0	0	0	<b>658,977.16</b>
<b>Të ardhura te dokumentuara</b>	38,948.00	460,911.60	457,431.85	683,143.97	445,832.20	116,325.00	<b>2,202,592.62</b>
Të ardhura	38,948.00	460,911.60	457,431.85	683,143.97	445,832.20	116,325.00	2,202,592.62
<b>Shpenzime</b>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	<b>52,692.20</b>
Shpenzime jetike	0	0	0	0	0	0	0
Udhëtime jashtë vendit (TMS)	0	0	0	0	0	0	52,692.20
<b>Mundësia për kursim</b>	38,948.00	460,911.60	457,431.85	683,143.97	445,832.20	116,325.00	<b>1,490,923.26</b>

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e depozitës bankare në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 8,300 USD.

**24.4.** Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklarin të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

## 25. Depozitë bankare në vlerën 1,266,000 lekë, në “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>18</sup>

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** të ardhurat nga puna si jurist në Institutin e Studimeve Urbanistike, në Ministrinë e Ekonomisë dhe bursa e Shkollës së Magjistraturës, plus interesat bankare.

### Hetimi<sup>19</sup>/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

**25.1.** Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2020, të “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton se në datën 10.11.2005<sup>20</sup> subjekti ka çelur depozitë 3-mujore në shumën 700,000 lekë. Për gjatë viteve 2005 - 2016 subjekti e ka përdorur këtë shumë së bashku me interesat për krijimin e depozitave periodike. Në datën 31.3.2016 depozita ka qenë në vlerën 1,265,933.95 lekë, me afat maturimi 31.3.2017. Në datën 16.5.2017 subjekti ka kryer një transfertë, me përshkrimin “Transfertë te RZB, pagesë të të tretëve, urdhëruesi: Endrit E.Bimi, përfituesi: A.S.K, huadhënie, shuma 1,275,068.35 lekë”.

Subjekti është pyetur mbi arsyen e transferimit të këtyre fondeve dhe në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2 ka deklaruar se: “Arsyeja e transfertës është dhënie huaje në favor të z. A. K, pa interes, në mirëbesim, pa kontratë”.

**Tabela nr. 4** – analiza financiare për mundësinë e krijimit të depozitës në vlerën 1,266,000 lekë

	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004	Datë 10.11.2005	Kumulative, periudha 2000 – 10.11.2005
<b>Pasuria</b>	-	-	-	-	-	-	<b>1,358,977.16</b>
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	-	-	-	-	-	-	1,358,977.16
<b>Detyrime</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>Pasuri neto</b>	-	-	-	-	-	-	<b>1,358,977.16</b>
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	38,948.00	460,911.60	457,431.85	683,143.97	445,832.20	426,525.00	<b>2,512,792.62</b>
Të ardhura	38,948.00	460,911.60	457,431.85	683,143.97	445,832.20	426,525.00	2,512,792.62
<b>Shpenzime</b>	-	-	-	-	-	-	<b>52,692.20</b>
Shpenzime jetike	-	-	-	-	-	-	-
Udhëtime jashtë vendit (TIMS)	-	-	-	-	-	-	52,692.20
<b>Mundësia për kursim</b>	38,948.00	460,911.60	457,431.85	683,143.97	445,832.20	426,525.00	<b>1,101,123.26</b>

**25.2.** Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e depozitës.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti dhe përgjigjeve të tij në pyetësor, në analizën financiare janë konsideruar të ardhura të dokumentuara, si më poshtë vijon:

<sup>18</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank”; (ii) shkresë nr. \*\*\*prot., datë 1.11.2016, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore; (iii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2016, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore; si dhe (iv) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2016, e Shkollës së Magjistraturës.

<sup>19</sup> Shkresë nr.\*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar “Intesa Sanpaolo Bank”; dhe shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2020.

<sup>20</sup> Deklaruar në DVP/2006.

- të ardhurat nga paga si jurist në ISPU dhe në Ministrinë e Ekonomisë për vitet 2000 - 2004, në vlerën 815,620 lekë.
- të ardhurat si student në Shkollën e Magjistraturës për periudhën 2004 – 4.10.2006, në vlerën 542,850 lekë;
- të ardhurat nga puna si koordinator me kohë të pjesshme për rreth 3.5 vjet në fondacionin “Për edukimin ekonomik të të rinjve, në vlerën 7,500 USD.

Nuk janë konsideruar shpenzimet jetike bazuar në deklaratimet e subjektit në pyetësonin nr. 2, ku ka deklaruar se deri në fund të vitit 2006 (kohë kur ka filluar detyrën e prokurorit) shpenzimet e tij jetike vazhdonin të mbuloreshin prej prindërve, ndërsa të ardhurat kurseheshin për llogarinë e tij, të cilat janë kursimet e deklaruara në deklaratën fillestare. Nga analiza financiare e prindërve të subjektit rezulton se ata kanë pasur mundësi për të mbuluar shpenzimet jetike të subjektit deri në vitin 2006<sup>21</sup>.

**25.3.** Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

## **26. Depozitë bankare në vlerën 2,500,000 lekë, në “Credins Bank”<sup>22</sup>**

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** të ardhurat nga paga ndër vite si prokuror, plus interesa bankare.

### **Hetimi<sup>23</sup>/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

**26.1.** Bazuar në shkresën e “Credins Bank”, rezulton se:

- Në datën 3.11.2010 subjekti ka hapur llogari rrjedhëse, e cila është furnizuar me fonde nga kalimi i pagës mujore. Gjendja e llogarisë bankare në datën 31.12.2010 rezulton të jetë 129,504 lekë.
- Në datën 25.3.2013 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,173,883.90 lekë, prej të cilave është kryer kalimi i shumës prej 1,010,000 lekësh për çelje depozite bankare nr. \*\*\*, me afat maturimi 6-mujor. Pas maturimit periodik fondet janë rinvestuar në vijim dhe në datën 15.10.2015 kjo depozitë rezulton me gjendje 1,087,173.11 lekë.
- Në datën 15.10.2015 llogaria e pagës rezulton të jetë me gjendje 1,476,521.47 lekë, prej të cilës subjekti ka transferuar në depozitë bankare shumën 1,400,000 lekë.

Nga nxjerrjet e llogarive bankare rezulton se në datën 15.10.2015 fondet e depozitës nr. \*\*\* në vlerën 1,087,137.11 lekë dhe fondet e llogarisë së pagës në vlerën 1,400,000 lekë kanë shërbyer si burim për çeljen e depozitës nr. \*\*\*, me vlerë principali 2,517,933.45 lekë, e cila vjen në datën 23.1.2017 me gjendje 2,510,493.92 lekë.

Në datën 17.5.2017 subjekti ka mbyllur depozitën e mësipërme, duke e kaluar shumën totale të saj në llogarinë e pagës, e cila, pas transferimit të fondeve nga depozita, rezulton të ketë gjendje 3,273,035.16 lekë. Në po të njëjtën datë subjekti ka transferuar shumën 3,000,000 lekë në emër të shtetasit A.S.K, me përshkrimin “Hua”.

<sup>21</sup> Referohuni analizës financiare të prindërve në faqen 8.

<sup>22</sup> Subjekti ka bashkëlidhur: (i) konfirmim nr. \*\*\*prot., datë 17.10.2016, të “Credins Bank”; (ii) vërtetim datë 20.10.2016, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës lidhur me të ardhurat *neto* të përfituara nga subjekti gjatë detyrës pranë kësaj prokurorie për periudhën tetor 2006 – dhjetor 2007; (iii) vërtetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë lidhur me të ardhurat *neto* të përfituara nga subjekti gjatë detyrës pranë kësaj prokurorie për periudhën janar 2008 – maj 2012; (iv) vërtetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me të ardhurat *neto* të përfituara nga subjekti gjatë detyrës pranë kësaj prokurorie për periudhën 2012 – 2016.

<sup>23</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar “Credins Bank”; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2020, e “Credins Bank”.

## 26.2. Analiza financiare për krijimin e depozitës 2,500,000 lekë

**Tabela nr. 5** – analiza financiare për periudhën 3.11.2010 – 25.3.2013, për krijimin e shumës 1,010,000 lekë

	<b>Datë 3.11.2010</b>	<b>Viti 2011</b>	<b>Viti 2012</b>	<b>Datë 25.3.2013</b>
<b>Pasuria</b>	<b>-51,294.69</b>	<b>-122,293.56</b>	<b>706,050.06</b>	<b>3,524,049.93</b>
Automjet “Mercedes-Benz”, vitit 2000				771,155.00
<i>Ndryshim likuiditeti (shtesa/pakësime)</i>	<i>-51,294.69</i>	<i>-122,293.56</i>	<i>706,050.06</i>	<i>3,524,049.93</i>
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Pasuri neto</b>	<b>-51,294.69</b>	<b>-122,293.56</b>	<b>706,050.06</b>	<b>3,524,049.93</b>
Të ardhura të dokumentuara	872,495.74	848,329.98	1,022,766.00	4,725,393.51
Të ardhura të subjektit	864,940.08	843,903.00	1,022,766.00	222,274.50
Të ardhurat të bashkëjetueses				12,806.00
Të ardhura nga interesat bankare	7,555.66	4,426.98	0	21,054.83
Të ardhura nga znj. L.K para bashkëjetesës <sup>24</sup>				4,469,258.18
<b>Shpenzime</b>	<b>632,850.60</b>	<b>376,620.00</b>	<b>283,344.00</b>	<b>146,785.23</b>
Shpenzime jetike	125,235.00	136,620.00	139,548.00	99,892.00
Udhëtime jashtë vendit ( <i>TIMS</i> )	287,615.60	0	43,796.00	
Udhëtime pune brenda vendit	220,000.00	240,000.00	100,000.00	
Shpenzime (blerje) me kartë krediti, znj. L. K				46,893.23
<b>Mundësia për kursim</b>	<b>290,939.84</b>	<b>594,003.54</b>	<b>33,371.94</b>	<b>1,054,558.35</b>

**Tabela nr. 6** – analiza financiare për periudhën 1.1.2015 – 15.10.2015, për krijimin e shumës 1,400,000 lekë

	<b>Datë 15.10.2015</b>
<b>Pasuria</b>	<b>711,780.69</b>
<i>Ndryshim likuiditeti (shtesa/pakësime)</i>	<i>711,780.69</i>
<b>Detyrime</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuri neto</b>	<b>711,780.69</b>
Të ardhura të dokumentuara	2,169,723.31
Të ardhura të subjektit	1,091,096.67
Të ardhura të bashkëjetueses	1,034,737.50
Të ardhura nga interesat bankare	43,889.14
<b>Shpenzime</b>	<b>560,690.00</b>
Shpenzime jetike	560,690.00
<b>Mundësia për kursim</b>	<b>897,252.62</b>

Nga analiza financiare si më sipër rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite.

**26.3.** Nga hetimi ka rezultuar se në datën 8.9.2006, 1 muaj para fillimit të detyrës, subjekti ka çelur depozitë në euro në shumën 4,000 euro.

<sup>24</sup> Gjendje likuiditet në banka të znj. L. K në momentin e fillimit të bashkëjetesës.

Në DVP/2007 subjekti ka deklaruar: “*Pakësuar llogari rrjedhëse në muajt janar dhe shkurt 2007, përkatësisht me nga 1,000 euro*”. Nga nxjerrja e llogarisë bankare rezulton se në datën 9.1.2007 subjekti ka tërhequr shumën 1,000 euro dhe në datën 24.10.2007 ka pakësuar fondet e mbetura të llogarisë me 1,000 euro.

Në datën 31.12.2007 llogaria bankare rezulton të jetë me gjendje 2,087.15 euro, shumë e cila mbartet dhe vjen deri në datën 10.8.2011, me tepricë 2,309.47 euro.

Subjekti ka tërhequr në datën 10.8.2011 *cash* shumën 2,306.24 euro dhe e ka mbyllur këtë llogari bankare.

**Tabela nr. 7 – analizë financiare për depozitën në shumën 4,000 euro**

	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Datë 8.9.2006
<b>Pasuria</b>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,358,977.16	<b>208,870.02</b>
<i>Ndryshim likuiditeti</i>						1,358,977.16	208,870.02
<b>Detyrime</b>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	<b>0.00</b>
<b>Pasuri neto</b>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,358,977.16	<b>208,870.02</b>
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	38,948.00	460,911.60	457,431.85	683,143.97	445,832.20	465,300.00	<b>319,018.50</b>
Të ardhura	38,948.00	460,911.60	457,431.85	683,143.97	445,832.20	465,300.00	319,018.50
Shpenzime	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	52,692.20	38,090.63
Shpenzime jetike	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Udhëtime jashtë vendit (TIMS)						52,692.20	38,090.63
<b>Mundësia për kursim</b>	38,948.00	460,911.60	457,431.85	683,143.97	445,832.20	-946,369.36	<b>72,057.85</b>
<b>Mundësia kumulative për kursim</b>	38,948.00	499,859.60	957,291.45	1,640,435.42	2,086,267.62	1,139,898.26	<b>1,211,956.11</b>

Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me depozitat e mësipërme. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

## **27. Gjendje në llogarinë rrjedhëse<sup>25</sup> të pagës si prokuror, në vlerën 538,000 lekë**

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** të ardhurat e pagës si prokuror.

### **Hetimi<sup>26</sup>/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

**27.1.** Bazuar në shkresën e “Credins Bank” rezulton se subjektit i kanë kaluar të ardhurat nga paga nëpërmjet llogarisë bankare të mësipërme, prej datës 3.11.2010. Gjendja e kësaj llogarie në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* është 538,218.08 lekë. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare për akumulimin e kësaj gjendjeje në bankë.

**27.2.** Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

## **28. Gjendje *cash* në vlerën 650,000 lekë**

<sup>25</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) konfirmim nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2016, nga “Credins Bank”; (ii) kupon bankomati datë 19.1.2017, nga “Credins Bank”, ku rezulton teprica e disponueshme në llogarinë e subjektit.

<sup>26</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2016, e “Credins Bank”.

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** të ardhurat nga paga ndër vite.

**28.1.** Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting gjendje cash në vlerën 650,000 lekë.*

Nga verifikimi i deklaratave periodike ka rezultuar se:

- i. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 500,000 lekë.
- ii. Në DPV/2006 subjekti ka deklaruar në total gjendje *cash* në vlerën 170,000 lekë.

**28.2.** Lidhur me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratat periodike vjetore, subjekti ka sqaruar<sup>27</sup>: “Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2006 kam deklaruar gjendje *cash* në banesë 500,000 lekë. Në deklaratën e vitit 2006 kam deklaruar gjendje *cash* krijuar nga shitja e makinës, prej 80,000 lekësh, dhe gjendje *cash* nga kursimet e pagës prej 90,000 lekësh.

*Pra, në vitin 2006 kam pasur në total gjendje cash në banesë shumën 670,000 lekë. Kjo shumë është mbartur pothuaj e pa lëvizur deri në vitin 2016, deklaruar në deklaratën Vetting ‘gjendje cash 650,000 lekë’. Në lidhje me deklaratimet e mia të viteve 2010 – 2017, unë fillimisht kam deklaruar paga dhe të ardhura nga paga në të njëjtën vlerë, ndërsa nga viti 2014 e më pas, ku kam deklaruar paga dhe të ardhura nga paga në vlera të ndryshme, tek pjesa e pagave kam pasur parasysh shumat që janë shtuar në llogaritë bankare të pagës nga njëri vit në tjetrin. Konkretisht, në vitin 2014 kam deklaruar vlerë rreth 800,000 lekë, gjendja e llogarisë së pagës pranë ‘Credins Bank’ ka qenë 948,112 lekë. Në vitin 2015 kam deklaruar pagë 700,000 lekë, pasi është afërsisht gjendja që kam shtuar në ‘Credins Bank’ gjatë këtij viti. Në vitin 2016 kam deklaruar 500,000 lekë, afërsisht sa gjendja në ‘Credins Bank’ 464,298 lekë. Këto deklarime kanë qenë një pasaktësi nga ana ime, duke mos i deklaruar si likuiditete në bankë, por nuk kanë të bëjnë me kursimet cash në banesë”.*

Në lidhje me gjendjen *cash* të deklaruar, shpjegimi i dhënë nga subjekti përputhet me lëvizjet bankare, shtesa dhe pakësime të likuiditeteve në bankë.

**Tabela nr. 8** – analiza financiare për periudhën përpara fillimit të detyrës

	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Deri më 4.10.2006	Totali
<b>Pasuria</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,358,977.16</b>	<b>1,096,512.21</b>	<b>2,455,489.37</b>
Autoveturë “Audi 80”							150,000.00	150,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>						1,358,977.16	946,512.21	2,305,489.37
Likuiditete						1,358,977.16	2,305,489.37	
<b>Detyrime</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuri neto</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,358,977.16</b>	<b>1,096,512.21</b>	<b>2,455,489.37</b>
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	<b>38,948.00</b>	<b>150,498.00</b>	<b>161,430.00</b>	<b>391,617.00</b>	<b>328,447.00</b>	<b>465,300.00</b>	<b>354,465.00</b>	<b>1,890,705.00</b>
Të ardhura të subjektit	38,948.00	150,498.00	161,430.00	391,617.00	328,447.00	465,300.00	354,465.00	1,890,705.00
<b>Shpenzime</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>52,692.20</b>	<b>38,090.63</b>	<b>90,782.83</b>
Shpenzime jetike	-	-	-	-	-	-	-	-
Udhëtime jashtë vendit (TIMS)						52,692.20	38,090.63	90,782.83
<b>Mundësia kumulative për kursim</b>	<b>38,948.00</b>	<b>189,446.00</b>	<b>350,876.00</b>	<b>742,493.00</b>	<b>1,070,940.00</b>	<b>124,570.64</b>	<b>-655,567.20</b>	<b>-655,567.20</b>

<sup>27</sup> Referohuni në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

Nga analiza rezulton se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare të krijojë gjendjen *cash* në shumën 500,000 lekë, për të krijuar gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në lidhje me këtë konstatim.

**28.3.** Në parashtrimet e tij, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se nëse Komisioni përfshin në analizën financiare të ardhurat nga punësimi me kohë të pjesshme pranë fondacionit “Për edukimin ekonomik të të rinjve” gjatë periudhës janar 2002 – tetor 2004, ai do të kishte të ardhura të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

**28.4.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe duke u mbështetur në analizën e kryer në pikën 24.3.3, ku ka vlerësuar të marrë në konsideratë dhe të përfshijë në analizën financiare shumën e deklaruar nga subjekti, si të përfituar nga puna e tij me kohë të pjesshme pranë fondacionit “Për edukimin ekonomik të të rinjve”, ka kryer një analizë të re financiare, si më poshtë vijon:

**Tabela nr. 9**

	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Deri më 4.10.2006	Totali kumulativ
<b>Pasuria</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,358,977.16</b>	<b>1,096,512.21</b>	<b>2,455,489.37</b>
Autoveturë “Audi **”							150,000.00	<b>150,000.00</b>
<i>Ndryshim likuiditeti</i>						1,358,977.16	946,512.21	2,305,489.37
<b>Detyrime</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuri neto (1-2)</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,358,977.16</b>	<b>1,096,512.21</b>	<b>2,455,489.37</b>
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	<b>38,948.00</b>	<b>460,911.60</b>	<b>457,431.85</b>	<b>683,143.97</b>	<b>445,832.20</b>	<b>465,300.00</b>	<b>354,465.00</b>	<b>2,906,032.62</b>
Të ardhura të subjektit	38,948.00	460,911.60	457,431.85	683,143.97	445,832.20	465,300.00	354,465.00	<b>2,906,032.62</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>52,692.20</b>	<b>38,090.63</b>	<b>90,782.83</b>
Shpenzime jetike	-	-	-	-	-	-	-	<b>0.00</b>
Udhëtime jashtë vendit (TMS)						52,692.20	38,090.63	<b>90,782.83</b>
<b>Mundësia kumulative për kursim</b>	<b>38,948.00</b>	<b>460,911.60</b>	<b>457,431.85</b>	<b>683,143.97</b>	<b>445,832.20</b>	<b>-946,369.36</b>	<b>-780,137.84</b>	<b>359,760.42</b>
<b>Mundësia kumulative për kursim</b>	<b>38,948.00</b>	<b>499,859.60</b>	<b>957,291.45</b>	<b>1,640,435.42</b>	<b>2,086,267.62</b>	<b>1,139,898.26</b>	<b>359,760.42</b>	

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruara në deklaratën *Vetting*.

Në përfundim, konkludohet se subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare për të krijuar gjendjen *cash* në shumën 650,000 lekë.

## **PASURITË E BASHKËJETUESES**

### **29. Automjet<sup>28</sup> tip “Mercedes-Benz”, viti 2000, blerë në qershor të vitit 2013, në vlerën 5,500 euro**

<sup>28</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2013, lidhur me shitësin B.M.

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** dhuratë nga babai me rastin e lindjes së vajzës.

### **Konstatimi i ILDKPKI-së**

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar të automjetit në vlerën 5.500 euro, të deklaruar nga znj. L. K (bashkëjetuesja e subjektit) në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2014 dhe në deklaratën e rivlerësimit Vetting.*

### **Hetimi<sup>29</sup>/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni**

**29.1.** Bashkëjetuesja e subjektit, znj. L.K, me kontratën e shitblerjes së automjetit, datë 14.5.2013, ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz” në shumën 5,500 euro.

Sipas dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja rezulton se përmes kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.5.2018, bashkëjetuesja e subjektit e ka tjetërsuar këtë automjet në favor të blerësit A.B, për çmimin 3,200 euro.

**29.2.** Në deklaratën Vetting bashkëjetuesja e subjektit deklaroi si burim për blerjen e këtij automjeti dhuratë<sup>30</sup> nga babai me rastin e lindjes së vajzës.

I pyetur<sup>31</sup> nga Komisioni lidhur me burimin e të ardhurave të babait të bashkëjetueses, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës së dhuruar në favor të vajzës së tij L.K, subjekti ka sqaruar: “Mesa më është bërë me dije nga babai i bashkëjetueses, që nga viti 1992 ai është regjistruar si person fizik për të ushtruar veprimtari private si mjek stomatolog, si dhe tregtimin e medikamenteve dhe pajisjeve të këtij profesioni. Po ashtu, të ardhura familjare kanë qenë edhe nga qiradhënia, nga pensioni grek i gjyshes nga mamaja të bashkëjetueses, etj.”.

Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me aftësinë financiare të shtetasit A.K për dhurimin e shumës 5,500 euro, duke marrë në konsideratë faktin se të ardhurat që kishin shërbyer për blerjen e automjetit kishin si burim dhurimin e kësaj shume.

**29.2.1. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga babai i bashkëjetueses së subjektit, nga hetimi<sup>32</sup> ka rezultuar se:**

**i.** Qendra Kombëtare e Biznesit ka informuar se shtetasi A.K figuron i regjistruar si person fizik pranë QKB-së, me datë 6.9.1994, me NIPT K\*\*\*G, me fushë veprimtarie të aktivitetit të paplotësuar. Aktualisht ky subjekt figuron me status “çregjistruar”.

QKB-ja ka konfirmuar gjithashtu se babai i bashkëjetueses së subjektit është pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit “klinike dentare”, me nr. \*\*\*, datë 19.2.2008.

**ii.** ISSH-ja ka informuar se mbi bazë të dokumenteve që ky institucion disponon, shtetasi A.K rezultoi i regjistruar pranë qendrës së punës “Këshilli popullor Fsh. Bashkia Maminas”, me detyrë mjek stomatolog, për periudhën 22.11.1976 – 31.8.1978. Në këtë dokument nuk citohet masa e pagës së përfutur nga punësimi i tij pranë këtij punëdhënësi.

**iii.** ILDKPKI-ja, në lidhje me aktivitetin “klinike dentare” të babait të bashkëjetueses së subjektit, z. A. K, ka bashkëlidhur dokumentacionin e mëposhtëm:

- deklaratë parashikuese e qarkullimit vjetor, datë 17.3.2017;
- njoftim vlerësimi tatimor, datë 27.3.2007; si dhe

<sup>29</sup> Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 14.1.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; shkresë thim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2020.

<sup>30</sup> I njëjti burim është deklaruar edhe në DVP/2014.

<sup>31</sup> Shihni përgjigjen në pyetësorin nr. 1.

<sup>32</sup> (i) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, dërguar QKB-së; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2020, e QKB-së; (ii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2020, e DRT-së Tiranë; (iii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2021, dërguar ILDKPKI-së; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2021, e ILDKPKI-së; (iv) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.5.2021, dërguar ISSH-së; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021, e ISSH-së.



- dokument i përllogaritjes së taksës vendore dhe tatimit të thjeshtuar të fitimit për vitet 2005 dhe 2006.

**iv.** DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2020, ka informuar se shtetasi A.S.K është regjistruar si person fizik me NIPT K\*\*\*G, me vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 6.9.1994, me aktivitet “klinikë dentare”. Në datën 11.2.2010 subjekti është çregjistruar nga sistemi tatimor dhe nuk ka detyrime të palikuiduara.

#### **DRT-ja ka konfirmuar se të ardhurat e realizuara ndër vite janë si më poshtë vijon:**

- **Për vitin 1994** (tetor, nëntor, dhjetor) është paguar tatim 8,000 lekë:
  - MA \*\*\*, datë 5.12.1994, shuma 3,400 lekë;
  - MA \*\*\*, datë 25.1.1995, shuma 1,500 lekë;
  - MA \*\*\*, datë 17.2.1995, shuma 3,200 lekë.
- **Për vitin 1995** është paguar tatim 19,400 lekë (fletë njoftimi tatimi, datë 1.4.1996).
- **Për vitin 1996** është paguar tatim 25,000 lekë:
  - fletë njoftimi tatimi, datë 1.4.1996, shuma 25,000 lekë “pagesë për periudhën 1.4.1996 – 31.12.1996”;
  - deklaratë e shtetasit A.K në datën 21.1.1997, sipas të cilës deklaroi xhiron e realizuar për vitin 1996 në vlerën 310,500 lekë dhe xhiro e parashikuar për vitin 1997 është në vlerën 414,000 lekë.
- **Për vitin 1997** është paguar tatim 60,000 lekë:
  - fletë njoftimi tatimi, datë 25.5.1997, shuma 60,000 lekë “pagesë për periudhën 1.1.1997 – 31.12.1997”.
- **Për vitin 1998** është paguar tatim 60,000 lekë:
  - fletë njoftimi tatimi, datë 10.2.1998, shuma 60,000 lekë “pagesë për periudhën 1.1.1998 – 31.12.1998”;
  - deklaratë e shtetasit A.K në datën 10.2.1999, mbi xhiron e realizuar gjatë vitit 1998 në vlerën 1,000,000 lekë dhe xhiro e parashikuar për vitin 1999 në vlerën 1,000,000 lekë.
- **Për vitin 1999** është paguar tatim 60,000 lekë:
  - fletë njoftimi tatimi, datë 10.2.1999, shuma 60,000 lekë, pagesë për 3-mujorin e parë dhe të dytë.
- **Për vitin 2000** është paguar tatim 60,000 lekë:
  - fletë njoftimi tatimi, datë 13.2.2000, shuma 60,000 lekë, pagesë për 3-mujorin e parë dhe të dytë.
- **Për vitin 2001** është paguar tatim 60,000 lekë, si dhe 10,000 lekë shtesë tatimi:
  - fletë njoftimi tatimi, e vitit 2001, shuma 60,000 lekë, pagesë për 3-mujorin e parë dhe të dytë për xhiro deri në 2 milionë dhe 10,000 lekë pagesë për xhiro 2-5 milionë;
  - deklaratë nga shtetasi A.K, xhiro e realizuar për vitin 2001 është 1,200,000 lekë, xhiro e parashikuar për vitin 2002 është 3,000 lekë/ditë.
- **Për vitin 2002** është paguar tatim 80,000 lekë, si dhe 10,000 lekë shtesë tatimi:
  - fletë njoftimi tatimi datë 2.2.2001, shuma 81,000 lekë, pagesë për xhiro deri në 2,000,000 dhe 10,000 lekë pagesë për xhiron 2,000,000 - 5,000,000.
- **Për vitin 2003** është paguar tatim me kuotë fikse 45,000 lekë, qarkullim i deklaruar 2,000,000 lekë, si dhe shtesë tatimi në vlerën 20,000 lekë (bashkëlidhur fletë njoftimi i tatimit).
- **Për vitin 2004** është paguar tatim me kuotë fikse 45,000 lekë, qarkullim i deklaruar 3,000,000 lekë (bashkëlidhur fletë njoftimi i tatimit).

- **Për vitin 2005** është paguar tatim me kuotë fikse 45,000 lekë, qarkullim i deklaruar 4,600,000 lekë (bashkëlidhur fletë njoftimi i tatimit).
- **Për vitin 2006** është deklaruar shitje brenda vendit në shumën 3,600,000 lekë, blerje 2,000,000 lekë (bashkëlidhur situata financiare e printuar nga sistemi).
- **Për vitin 2007** nuk ka të dhëna, pasi subjektete e biznesit të vogël janë administruar nga bashkia (pushteti lokal).  
Në lidhje me të dhënat për vitin 2007, bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2017, të Bashkisë Tiranë (administruar në dosjen e ILDKPKI-së), rezulton se qarkullimi i deklaruar është 4,000,000 – 5,000,000 milionë lekë dhe kuota fikse e paguar pranë Bashkisë Tiranë në vlerën 90,000 lekë.
- **Për vitin 2008** është deklaruar shitje brenda vendit në shumën 5,040,362 lekë, shpenzime 3,990,362 lekë dhe fitimi 1,050,000 lekë (bashkëlidhur deklarata e të ardhurave dhe shpenzimeve të nxjerra nga arkiva).
- **Për vitin 2009** është deklaruar shitje brenda vendit në shumën 2,400,000 lekë, shpenzime 1,350,000 lekë dhe fitimi 1,050,000 lekë (bashkëlidhur situata financiare e printuar nga sistemi).
- **Për vitin 2010** është deklaruar shitje brenda vendit 0 lekë, shpenzime 0 lekë dhe fitimi 0 lekë (bashkëlidhur situata financiare e printuar nga sistemi).

Në datën 11.2.2010 subjekti është çregjistruar nga sistemi tatimor dhe nuk ka detyrime të palikuiduara.

Komisioni, nisur nga fakti i mungesës së fitimit *neto* (për periudhën 1994 – 2007, konfirmuar nga DRT-ja), nga ushtrimi i aktivitetit të babait të bashkëjetueses së subjektit, si dhe nga domosdoshmëria për të mbledhur prova e fakte me qëllim kryerjen e një hetimi sa më objektiv dhe të gjithanshëm, për provueshmërinë e burimit të të ardhurave të babait të saj i kërkoi informacion Urdhrit të Stomatologut në lidhje me marzhin e fitimit të aktivitetit “klinikë dentare” për periudhën 1994 – 2007. Urdhri i Stomatologut ka paraqitur opinion<sup>33</sup>, duke konfirmuar marzhe të ndryshme fitimi në varësi të llojit të specialitetit, si më poshtë vijon:

- specialitetin e terapisë (mjekim i kariesit), me marzh fitimi 70-80%;
- specialitetin e ortodontisë (drejtimi i dhëmbëve të fëmijët), me marzh fitimi 60-70%;
- specialitetin e ortodontisë (shërbimi kryesor ku dentisti bën volumin më të madh të punës, vënia ose zëvendësimi i dhëmbëve), me marzh fitimi 40-50%;
- specialitetin e kirurgjisë, 70-80%.

Në kushtet kur nga Urdhri i Stomatologut u paraqitën marzhe të ndryshme fitimi në varësi të specialitetit, Komisioni, në datën 22.9.2021 i kërkoi informacion subjektit mbi specialitetet e dentistrisë që kishte ofruar në klinikën e tij dentare babai i bashkëjetueses, z. A.K, për periudhën 1994 – 2007. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë kërkesë, ka deklaruar se babai i bashkëjetueses, z. A.K, ka ofruar në klinikën e tij kryesisht shërbime në specialitetin e terapisë dhe kirurgjisë dentare, vërtetuar me dëshmitë përkatëse, bashkëlidhur pyetësorit të datës 22.9.2021<sup>34</sup>.

Trupi gjykues, në mbledhjen *online* të datës 12.10.2021, pasi analizoi dokumentacionin e administruar, vendosi që marzhi i fitimit i klinikës dentare për periudhën 1994 – 2007 të

<sup>33</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2021, drejtuar Urdhrit të Stomatologut; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2021, e Urdhrit të Stomatologut.

<sup>34</sup> Certifikatë mirënjohjeje, lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Stomatologut, nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2017, “Për kontribut të veçantë mbi 40-vjeçar në rritjen dhe zhvillimin e shërbimit stomatologjik...”; dëshmi lëshuar nga Universiteti i Tiranës në datën 22.2.1984, “A. K ka dhënë provimin e Pedodontisë”; dëshmi lëshuar nga Universiteti i Tiranës në datën 31.10.1983, “A. K ka dhënë provimin në lëndën Kirurgji Stomatologjike”.

konsiderohet në masën 65%<sup>35</sup>. Bazuar në këtë marzh fitimi, Komisioni llogariti të ardhurat e përfituara nga shtetasi A.K për periudhën 1996 – 2007, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

---

<sup>35</sup> Marzhi 65% është llogaritur si mesatare aritmetike e marzheve të përcaktuar për çdo grup - specialitet në përgjigjen e Urdhrit të Stomatologut.

Vitet	Baza ligjore	Masa e tatimit për biznesin e vogël	Të ardhura	Shpenzime	Fitimi i tatueshëm	Qarkullimi	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	Kuota fikse	4% mbi xhiron 2-... mln	Marzhi i fitimit	Fitimi i konsideruar në analizë
1994						-	8,100.00		-		
1995						-	19,400.00		-		
1996			310,500.00			310,500.00	25,000.00		-	0.65	201,825.00
1997			414,000.00			414,000.00	60,000.00		-	0.65	269,100.00
1998	<i>Ligji nr. 8313, datë 26.3.1998, "Për tatimin mbi biznesin e vogël"</i>	<i>Kuotë fikse për xhiron 0-2 mln lekë/vit + 4% mbi xhiron 2-5 mln</i>	1,000,000.00			1,000,000.00	60,000.00		-	0.65	650,000.00
1999			1,000,000.00			1,000,000.00	60,000.00		-	0.65	650,000.00
2000			1,300,000.00			1,300,000.00	60,000.00		-	0.65	845,000.00
2001	<i>Ligji nr. 7815, datë 15.12.2000, "Për disa ndryshime ne ligjin nr. 8313, datë 26.3.1998, "Për tatimin mbi biznesin e vogël"</i>	<i>Kuotë fikse per xhiron 0-2 mln lekë/vit + 4% mbi xhiron 2-8 mln</i>	1,200,000.00			1,200,000.00	60,000.00		10,000.00	0.65	780,000.00
2002			1,095,000.00			1,095,000.00	81,000.00		10,000.00	0.65	711,750.00
2003	<i>Ligji nr. 8978, datë 12.12.2002 "Për taksën vendore për biznesin e vogël"</i>	<i>Taksë vendore sipas llojit të aktivitetit/tatim i thjeshtuar mbi fitimin 4% mbi qarkullimin total të realizuar</i>	2,500,000.00			2,500,000.00	100,000.00	40,500.00		0.65	1,625,000.00
2004			3,000,000.00			3,000,000.00	90,000.00	40,500.00		0.65	1,950,000.00
2005			4,600,000.00			2,436,500.00	138,000.00	43,650.00		0.65	1,583,725.00
2006			3,600,000.00			3,600,000.00		54,000.00		0.65	2,340,000.00
2007			4,300,000.00			2,000,000.00	-	90,000.00		0.65	1,241,500.00

2008	Ligj nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore"	Personat fizikë kuote fikse në organet vendore bashki + për xhiron 2-8 mln lekë/vit deklarojnë në DRT dhe paguajnë tatim të thjeshtuar mbi fitimin 10% mbi qarkullimin total		3,990,362.00	1,050,000.00	5,040,362.00	105,000.00				945,000.00
2009				1,350,000.00	1,050,000.00	2,400,000.00	105,000.00				945,000.00
2010			Në datën 11.2.2010 subjekti është çregjistruar nga sistemi tatimor								
<b>Fitimi Total</b>											<b>14,737,900.00</b>

Bazuar në analizën e mësipërme, fitimi i gjeneruar nga shtetasi A.K nga aktiviteti i tij në klinikën dentare për vitet 1994 - 2010 është në vlerën 14,737,900 lekë.

### **29.2.2. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga babai i bashkëjetueses së subjektit nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme**

Në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit kopje të kontratave të qirave të lidhura mes prindërve të bashkëjetueses, në cilësinë e qiradhënësve, dhe qiramarrësve, si më poshtë vijon:

a) Kontratë qiraje, datë 18.12.2009, lidhur me “Alpha Bank”, me objekt “qiradhënien e apartamentit 2+1 në rr. ‘A.Z.C’, me vlerë qiraje mujore 388.89 euro”. Afati i kësaj kontrate shtrihet nga data 1.1.2010 deri më 31.12.2010. Për të vërtetuar pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga kjo qiradhënie, subjekti ka paraqitur vërtetimin datë 29.6.2021, të “Alpha Bank”, ku konfirmohet se pagesa e tatimit është kryer nga ky institucion.

b) Kontratat e qirave lidhur mes qiradhënësit A. K dhe qiramarrësit V.D, me objekt “qiradhënien e apartamentit me sip. 120 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rrugën e Bogdanëve”:

- kontratë qiraje, datë 9.5.2003, me vlerë qiraje mujore 350 USD – afati i kësaj kontrate është 1 (një) vit me të drejtë rinovimi;
- kontratë qiraje datë 31.12.2005, me vlerë qiraje mujore 45,000 lekë – afati i kësaj kontrate është 3 (tre) vite me të drejtë rinovimi.

Për të vërtetuar pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga kjo qiradhënie, subjekti ka paraqitur vërtetimin e datës 1.7.2021, nga Kuvendi, sipas të cilit konfirmohet se qiramarrja e z. V. D është bërë në përputhje me vendimin nr. 68, datë 20.2.2003, “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”, si dhe vërtetimin e datës 15.7.2021, nga Kuvendi, nga përmbajtja e të cilit konfirmohet pagesa e tatimit në burim nga ky institucion, për qiramarrjen e deputetit V. D.

c) Kontratë qiraje, datë 28.5.2012, lidhur mes qiradhënësës N. K dhe qiramarrësit Xh. O, me objekt “qiradhënien e apartamentit me sip. 25 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. ‘Mine Peza’, me vlerë qiraje mujore 20,000 lekë”. Afati i kësaj kontrate shtrihet nga data 2.5.2012 deri më 2.5.2013.

Për të vërtetuar pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga kjo qiradhënie, subjekti, me anë të pyetësorit datë 22.6.2021, ka paraqitur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.7.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë, sipas së cilës rezulton se kjo drejtori administron në dosjen tatimore të subjektit kontratën e qirasë së sipërcituar, për të cilën janë likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore. Tatimi në burim për të ardhurat e përfituara nga qiraja përfshihet në “tatimet kombëtare” e jo ato vendore. Për pasojë, Komisioni vlerëson se shkresa e sipërcituar e Bashkisë Tiranë nuk provon pagimin e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura. Për pasojë, të ardhurat e përfituara nga shtetasja N. K, sipas kësaj kontrate qiraje, nuk janë përfshirë në analizën financiare.

### **29.2.3. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga babai i bashkëjetueses së subjektit nga pensionet e gjyshes**

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar: *“Babai i bashkëjetueses më ka bërë me dije se që nga viti 1978 dhe deri kur ka ndërruar jetë gjyshja e bashkëjetueses ka jetuar në një shtëpi bashkë me prindërit e bashkëjetueses në adresën: rr. ‘Mine Peza’, p. \*\*, sh. \*\*. Shpenzimet jetike të saj janë përballuar me pensionin që merrte nga shteti shqiptar. Babai i bashkëjetueses më shpjegoi se shuma e përfiturar është 100 %, pasi, duke qenë se gjyshja jetonte në një shtëpi me to të ardhurat mbaheshin dhe ruheshin prej tyre. Me vdekjen e saj, duke qenë se mamaja e bashkëjetueses ishte fëmijë i vetëm, të gjithë të ardhurat e saj i mbetën automatikisht familjes së bashkëjetueses.*

*Këto të ardhura janë dërguar nëpërmjet z. Th.K, rezident në Janinë, i autorizuar nga gjyshja për të tërhequr pensionin në emër të saj. Një pjesë e këtyre të ardhurave janë dërguar nga z.*

*K në rrugë bankare dhe dorazi nëpërmjet shoferëve të linjës Janinë - Tiranë në periudha të ndryshme kohore”.*

Për të vërtetuar të ardhurat e përfituara nga shtetasja E.P<sup>36</sup> (gjyshja nga ana e nënës së bashkëjetueses), subjekti ka paraqitur:

- i. vërtetim<sup>37</sup> datë 13.2.2020, nga Ministria e Punës, Sigurimit Social dhe Solidaritetit Social, Republika Greke, sipas të cilit rezulton se shtetasja E.K.P në periudhën 2010 – 2013 ka përfituar në total shumën 20,489.4 euro, si e moshuar e pasiguruar;
- ii. fragment të *statement*-it nga llogaria bankare e shtetasit A.K në “Alpha Bank”, ku evidentohet transfertë z. K, me përshkrimin “pension K.Th”;
- iii. vërtetim datë 1.7.2021, nga ISSH-ja, sipas të cilit rezulton se shtetasja E.K.P është trajtuar me pension familjar për periudhën 14.10.1995 – 30.4.2015;
- iv. vërtetim datë 29.6.2021, nga Njësia Administrative nr. 10, sipas të cilit rezulton se shtetasja E.K.P ka qenë banore në rrugën “Mine Peza” në të njëjtën banesë me shtetasit A e N. K.

### **Analiza financiare**

**29.2.4.** Bazuar në dokumentacionin e mësipërm, trupi gjykues, në mbledhjen *online* të datës 12.10.2021, vendosi që në analizën financiare të shtetasit A.K të përfshijë të ardhurat si më poshtë vijon:

- Të ardhurat nga klinika dentare ndër vite deri në momentin e blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz” në datën 14.5.2013, në shumën 14,737,900 lekë.
- Të ardhurat nga kontratat e qirave të përfituara nga shtetasit A e N.K në shumën 2,964,279.85 lekë.
- Të ardhurat nga pensioni suplementar/familjar i gjyshes së bashkëjetueses së subjektit E. P, në shumën 1,105,778.10 lekë.
- Të ardhurat nga pensioni në shtetin grek i gjyshes së bashkëjetueses së subjektit E.P në shumën 2,790,512.62 lekë.

Shpenzimet jetike të përfshira në analizë financiare janë përlllogaritur për 5 persona, ku janë përfshirë bashkëjetuesja e subjektit, prindërit e saj, vëllai dhe gjyshja.

**Tabela nr. 10**

	<b>Totali kumulativ (datë 14.5.2013)</b>
<b>Pasuri</b>	<b>11,491,413.13</b>
Pasuri të paluajtshme	3,843,000.00
Pasuri të luajtshme	771,155.00
<i>Ndryshim (shtesë/pakësim), likuiditeti</i>	<i>6,877,258.13</i>
<b>Detyrime</b>	<b>0.00</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>22,162,270.58</b>
Të ardhura nga klinika dentare	14,737,900.00
Të ardhura, znj. L. K	553,800.00
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	250,000.00
Të ardhura nga qiratë	2,964,279.85
Të ardhurat e znj. E. P (gjyshja), pension në AL	1,105,778.10
Të ardhurat e znj. E.P (gjyshja), pension në GR	2,790,512.62
<b>Shpenzime</b>	<b>9,465,130.00</b>
Shpenzime jetike	9,465,130.00
<b>Mundësia për kursim</b>	<b>1,553,975.70</b>

<sup>36</sup> Referuar dëshmisë së trashëgimisë ligjore të administruar në shkresën kthim përgjigje të ASHK-së, rezulton se znj. E. K. P është nëna e shtetasës N.K, pra, gjyshja e bashkëjetueses së subjektit.

<sup>37</sup> Vërtetimi është paraqitur i shoqëruar me vulë apostille dhe i përkthyer në gjuhën shqipe.

Nga analiza financiare rezulton se babai i bashkëjetueses së subjektit ka pasur të ardhura financiare të mjaftueshme, me burim të ligjshëm për dhurimin e shumës 5,500 euro, e cila ka shërbyer për blerjen e automjetit nga shtetasja L.K.

**29.3.** Në përfundim, konkludohet se subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare për të krijuar këtë pasuri.

**30. Depozitë bankare në “Raiffeisen Bank”, e krijuar në janar të vitit 2007 e në vazhdim, e ndarë në:**

- i. fond investimi<sup>38</sup> në lekë, me principal në total 1,700,000 lekë;
- ii. fond investimi<sup>39</sup> në euro, me principal në total 10,000 euro;
- iii. llogari biznesi<sup>40</sup> me gjendje 1,193 lekë;
- iv. llogari rrjedhëse në lekë, me gjendje 145,502 lekë;
- v. depozitë bankare në euro, principal plus interesa në vlerën 7,606.40 euro;
- vi. depozitë bankare në euro, principal plus interesa në vlerën 3,131.52 euro;
- vii. depozitë bankare në dollarë<sup>41</sup>, principal plus interesa në vlerën 24,606 USD.

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** pjesë nga të ardhurat e siguruara nga biznesi familjar privat (klinikë dentare) ku punon si mjeke stomatologe së bashku me babain mjek stomatolog, plus interesa bankare.

#### **Konstatimi i ILDKPKI-së**

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar (depozitat + llogari rrjedhëse) në vlerën totale rreth 8,000,000 lekë, si dhe të automjetit në vlerën 5,500 euro të deklaruara nga znj. L.K (bashkëjetuesja e subjektit) në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2014 dhe në deklaratën e rivlerësimit Vetting.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e të ardhurave në vlerën 10,000,000 lekë nga znj. L.K, deklaruar nga ana e saj nga biznesi familjar privat, ku punon si mjeke stomatologe së bashku me babain e saj.*

#### **Hetimi<sup>42</sup>/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni**

##### **30.1. Analiza e deklaramit të pasurisë**

###### ***i) Fond investimi në lekë, me principal në total 1,700,000 lekë***

Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Invest” rezulton se bashkëjetuesja e subjektit, znj. L. K, ka pasur marrëdhënie juridike me këtë bankë, ku ka investuar në “F.P”, si më poshtë vijon:

- Në datën 30.10.2012 ka blerë 573.05 kuota, me çmim 1,047.03 lekë/kuotë, në vlerë totale fondi 600,000 lekë.
- Në datën 14.11.2013 ka blerë 263.07 kuota, me çmim 1,140.37 lekë/kuotë, në vlerë totale fondi 300,000 lekë.
- Në datën 3.2.2015 ka blerë 659.57 kuota, me çmim 1,212.92 lekë/kuotë, në vlerë totale fondi 800,000 lekë.
- Në datën 23.1.2017 gjendja e “F.P” rezulton të jetë 1,700,000 lekë.
- Në datën 8.5.2017 ka tërhequr fondin total prej 2,113,631.29 lekësh, nga të cilat 2,050,986.6 lekë kalojnë në llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”. Me tej, në datën

<sup>38</sup> Subjekti ka paraqitur pasqyrë llogarie, datë 12.10.2016, nga “Raiffeisen Invest”.

<sup>39</sup> Subjekti ka paraqitur pasqyrë llogarie, datë 12.10.2016, nga “Raiffeisen Invest”.

<sup>40</sup> Subjekti ka paraqitur nxjerrje llogarie, datë 12.10.2016, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>41</sup> Subjekti ka paraqitur nxjerrje llogarie datë 12.10.2016, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>42</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, e “Raiffeisen Invest”; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, e “Raiffeisen Bank”.



11.5.2017 shtetasja L.K transferon në llogari të babait të saj A. K shumën 2,100,000 lekë, me përshkrimin “Kalim babait”.

**ii) Fond investimi në euro, me principal në total 10,000 euro**

Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Bank” rezulton se:

- Në datën 29.3.2016 bashkëjetuesja e subjektit ka depozituar shumën 10,000 euro, me përshkrimin “Të ardhura nga puna”, e cila, në po të njëjtën datë është transferuar në “Raiffeisen Invest.” Kjo shumë ka shërbyer për blerjen në datën 31.3.2016 të 89.76 kuota nga “Raiffeisen Invest”, me çmim 111.41 euro/kuotë, në vlerë totale fondi 10,000 euro.
- Në datën 8.5.2017 fondi total në shumën 10,311.15 euro ka kaluar në llogarinë rrjedhëse në euro të bashkëjetueses së subjektit në “Raiffeisen Bank”.
- Në datën 18.5.2017 bashkëjetuesja e subjektit ka transferuar shumën 7.300,4 euro në llogarinë e babait të saj A. K.
- Në datën 7.11.2017 bashkëjetuesja e subjektit ka transferuar shumën 9,029.17 euro në llogari të shtetasës F.T për blerje makine. Nga hetimi ka rezultuar se bashkëjetuesja e subjektit, me kontratën e shitjes datë 24.4.2018, ka blerë automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa AA \*\*\* TT, për shumën 10,000 euro. Kontrata e shitjes është lidhur në shtetin gjerman me palën shitësen F.T (B).
- Shtetasi A. B depoziton 3,200 euro pagesë për blerje automjeti, sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.5.2018. Përmes kësaj kontrate shtetasja L.K ka tjetërsuar në favor të shtetasit A. B automjetin tip “Mercedes-Benz”<sup>43</sup>, me targa AA \*\*\* GO.

**iii) Llogari biznesi me gjendje 1,193 lekë**

Kjo llogari është hapur në “Raiffeisen Bank” më 31.5.2011, me emërtimin “llogari tërheqje Master Card \*\*\*-EUR-\*\*\*” dhe ka pasur suport llogarinë nr. \*\*\*-EUR-\*\*\*, emërtuar “llogari ngurtësimi tërheqje Master Card”.

**iv) Llogari rrjedhëse në lekë, me nr. \*\*\*-ALL-\*\*\*, në vlerën 145,502 lekë, e hapur në datën 24.2.2012 në “Raiffeisen Bank”**

**v) Depozitë bankare në euro, principal plus interesa, në vlerën 7,606.40 euro**

**vi) Depozitë bankare në euro, principal plus interesa, në vlerën 3,131.52 euro**

Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Bank” ka rezultuar se:

- a. Në datën 5.1.2007 shtetasja L.K ka derdhur në llogarinë e saj nr. \*\*\*-EUR-\*\*\* shumën 2,100 euro. Këtë depozitë e ka furnizuar me fonde çdo muaj dhe më 31.12.2007 gjendja e llogarisë rezulton të jetë 3,417.61 euro, më 31.12.2008 gjendja e llogarisë rezulton të jetë 5,733.04 euro dhe më 31.12.2009 gjendja e llogarisë rezulton të jetë 3,506.21 euro.
- b. Në datën 5.2.2010 shtetasja L. K ka tërhequr shumën 3,501 euro dhe balanca e llogarisë më 31.12.2010 rezulton të jetë 5.83 euro.
- c. Në këtë llogari, në datën 29.3.2016 shtetasja L. K ka depozituar shumën 10,000 euro, me përshkrimin “L.K derdh në llogari të ardhura nga puna” dhe po në këtë datë i transferon në fond investimi në “Raiffeisen Invest” shumën 10,000 euro, shumë e cila është deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*.
- d. Nga kjo llogari, në datën 16.1.2008 çel depozitën në shumën 4,400 euro, e cila maturohet në datën 16.1.2009 në shumën 4,544.94 euro. Gjendja e llogarisë bankare nr. \*\*\*-EUR-\*\*\* në datën 16.1.2009 rezulton 10,269.98 euro. Në datën 4.2.2009 nga fondet e llogarisë

---

<sup>43</sup> Automjet i trajtuar në pikën 6 të relacionit.

shtetasja L.K hap depozitën në shumën 13,770 euro, e cila maturohet në datën 4.2.2010 në llogarinë nr. \*\*\*- Eur-\*\*\*.

Kjo depozitë maturohet në datën 4.2.2010 në shumën 14,266.32 euro dhe në datën 8.2.2010 shtetasja L. K bën kalim fondesh të shtetasit A.K shumën 13,565 euro.

- e. Në datën 14.10.2010 shtetasja L. K kalon fondet në depozite shumën 4,000 euro. Kësaj depozite, pas maturimit, i shton fonde 3,000 euro dhe çel depozitë me afat 1-vjeçar maturimi në shumën 7,013 euro, e cila vjen në datën 16.1.2017 pas maturimit periodik 1-vjeçar me vlerë 7,607.06 euro.

### **vii) Depozitë bankare në USD, principal plus interesa, në vlerën 24,606 USD**

Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 5.1.2011 shtetasi A.K, babai i bashkëjetueses së subjektit, ka transferuar shumën 23,000 USD në llogarinë e kësaj të fundit. Kjo shumë është mbyllur në depozitë dhe në datën 16.1.2017 rezulton të jetë me gjendje 24,606.43 USD. Në datën 11.5.2017 bashkëjetuesja e subjekti ka kaluar në llogarinë e babait të saj të gjithë shumën prej 24,559.40 USD dhe në datën 7.11.2017 ka kryer mbylljen e llogarisë.

### **30.2. Analiza e burimit të të ardhurave të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit**

Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit në lidhje me burimin e të ardhurave të bashkëjetueses së tij që kanë shërbyer për krijimin e depozitave të mësipërme. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar: *“Bashkëjetuesja më sqaroi se, siç është shprehur në DVP/2014, të ardhurat e saj kanë si burim të ardhurat e siguruara nga puna e përbashkët familjare, që buron nga biznesi privat, ku ka punuar që në moshë të vogël me babain. Të ardhurat më konkretisht kanë si burim për sa vijon: një pjesë të dhëna nga familja e origjinës së saj, në kuadër të marrëdhënies familjare prind-fëmijë, të kursyera ndër vite nga puna e përbashkët familjare, që nga krijimi i biznesit privat e në vazhdim, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore; pjesa tjetër nga paga e saj si e punësuar (që me mbarimin e Fakultetit të Mjekësisë, dega Stomatologji në vitin 2007) në këtë biznes familjar, për çka janë paguar dhe kontributet përkatëse”.*

Nga hetimi i Komisionit në lidhje me të ardhurat e bashkëjetueses së subjektit nga aktiviteti tregtar, rezulton se:

**i.** Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2020, informon se shtetasja L.A.K figuron e regjistruar si person fizik pranë QKB-së, me datë 2.2.2010, me aktivitet “klinikë dentare”. Aktualisht ky subjekt figuron me status “aktiv”.

**ii.** DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2020, informon se shtetasja L.A.K është regjistruar si person fizik me NIPT L\*\*\*D në datën 2.2.2010, me aktivitet “klinikë dentare”. Ky institucion informon se ky subjekt nuk ka detyrime të palikuiduara. Të ardhurat e deklaruara ndër vite për këtë NIPT për periudhën deri në blerjen e mjetit, janë si më poshtë vijon:

**Tabela nr. 11**

Vitet	Të ardhura	Shpenzime	Fitimi i tatueshëm	Qarkullimi	Kuota fikse /taksë vendore	Fitimi i konsideruar në analizë
2011	-	-	-		-	
2012	-	-	-		-	

2013	-	-	-	-	-	
2014	829,715.00	517,212.00	312,503.00	829,715.00	25,000.00	287,503.00
2015	1,822,801.00	603,479.00	1,219,322.00	1,822,801.00	25,000.00	1,194,322.00
2016	4,549,300.00	1,349,300.00	3,200,000.00	4,549,300.00	-	3,200,000.00
2017	4,607,000.00	1,357,000.00	3,250,000.00	4,607,000.00		3,250,000.00
2018	4,871,803.00	1,420,803.00	3,451,000.00	4,871,803.00		3,451,000.00
2019	4,908,330.00	1,227,330.00	3,681,000.00	4,908,330.00		3,681,000.00
<b>Total</b>						<b>15,063,825.00</b>

Bazuar në përgjigjet e dhëna nga subjekti, trupi gjykues, në mbledhjen e datës 12.10.2021, vendosi të kryejë analizën financiare, si më poshtë vijon, duke marrë në konsideratë:

- Faktin që shtetasja L. K para fillimit të bashkëjetesës ka jetuar me prindërit, vëllain dhe gjyshen, siç rezulton nga përgjigjet e subjektit në pyetësonin nr. 2.
- Të ardhurat nga klinika dentare e shtetasit A.K për periudhën 1994 – 2010 dhe të shtetasës L. K për periudhën 2010 – 2012.
- Të ardhurat e shtetasës L. K nga punësimi në klinikën dentare, në shumën 553,800 lekë.
- Të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme në shumën 2,724,279.85 lekë.
- Shpenzimet jetike të përfshira në analizë financiare janë përlllogaritur për 4 persona.

**Tabela nr. 12** – analiza financiare para fillimit të bashkëjetesës

	<b>Totali kumulativ, datë 31.12.2012</b>
<b>Pasuri</b>	<b>10,751,997.03</b>
Pasuri të paluajtshme	3,843,000.00
Pasuri të luajtshme	0.00
<i>Ndryshim (shitesë/pakësim), likuiditeti</i>	<i>6,908,997.03</i>
<b>Detyrime</b>	<b>0.00</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>18,265,979.85</b>
Të ardhura nga klinika	14,737,900.00
Të ardhura znj. L. K	553,800.00
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	250,000.00
Të ardhura nga qiratë	2,724,279.85
<b>Shpenzime</b>	<b>7,220,891.00</b>
Shpenzime jetike	7,220,891.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>293,091.82</b>

**30.3.** Nga analiza financiare rezulton se mundësia e kursimeve kumulative ndër vite ka qenë pozitive dhe se shtetasja L.K ka pasur mundësi të krijojë depozitat bankare dhe gjendjen *cash* të deklaruar ndër vite para fillimit të bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit në vitin 2013.

Në vlerësimin përfundimtar të çështjes në lidhje me mundësinë e babait të bashkëjetueses së subjektit për t'i dhënë kësaj të fundit të ardhura për të krijuar depozitat e mësipërme bankare, përpara bashkëjetesës me subjektin, si dhe për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, Komisioni i është referuar:

- Vendimit nr. 20/2019 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelit: “[...] për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi

*logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur [...]”.*

- ii. Vendimit nr. 15/2019 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: “[...] në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur. Pavarësisht, ky arsyetim në asnjë rast nuk duhet të pengojë organet e rivlerësimit që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo se janë përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me një person tjetër, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive”.

Bazuar në referimet e mësipërme, Komisioni ka analizuar dhe vlerësuar pasurinë e babait të bashkëjetueses vetëm në kufijtë e pasurisë së dhuruar, duke analizuar vetëm të ardhurat e tij që kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitave të mësipërme para fillimit të bashkëjetesës me subjektin. Komisioni ka hetuar në lidhje me të gjitha pasuritë e babait të bashkëjetueses dhe ka marrë në konsideratë dhe analizuar vetëm ato pasuri që janë krijuar pas fillimit të detyrës së subjektit. Nga hetimi në lidhje me pasuritë e babait të bashkëjetueses së subjektit nuk kanë lindur dyshime për fshehje pasurie, duke pasur parasysh faktin se një pjesë e tyre janë krijuar në një kohë të hershme, kur subjekti nuk kishte filluar detyrën, ndërsa pasuritë e tjera janë krijuar në një kohë kur nuk kishte filluar bashkëjetesën me znj. L. K. Gjithashtu, Komisioni mban në vëmendje se nuk janë llogaritur të ardhurat e tjera të krijuara nga familja e bashkëjetueses (të ardhurat e nënës dhe vëllait të bashkëjetueses, si dhe të ardhura të tjera që mund të jenë krijuar), për sa kohë nuk kanë shërbyer si burime për krijimin e depozitave të deklaruara.

**30.4.** Në përfundim, konkludohet se bashkëjetuesja e subjektit ka kryer deklarin të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare për të krijuar pasuritë e mësipërme.

### **31. Gjendje cash (kursime nga puna për vitin 2016) në vlerën 450,000 lekë**

Bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, gjendje cash në vlerën 450,000 lekë. Në lidhje me gjendjen cash të deklaruar nga bashkëjetuesja e subjektit në deklaratat periodike vjetore, si dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka sqaruar se në vitin 2016 bashkëjetuesja ka deklaruar fond investimi në euro në shumën 10,000 euro, me burim gjendjen cash të deklaruar më parë, si dhe pagesë për ruajtjen e qelizave staminale në vlerën 2,550 euro. Pra, kursimet cash të mbartura i ka depozituar në bankë dhe i ka shpenzuar. Gjatë këtij viti ka shtuar në cash shumën 450,000 lekë të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

Gjendja cash e bashkëjetueses në vitin 2015, sipas deklarimeve të subjektit, rezulton të jetë 1,700,000 lekë.

Në datën 29.3.2016 bashkëjetuesja e subjektit ka depozituar shumën 10,000 euro me përshkrimin “Të ardhura nga puna”, e cila, në po të njëjtën datë, transferohet në “Raiffeisen Invest”. Kjo shumë ka shërbyer për blerjen në datën 31.3.2016 të 89.76 kuota nga “Raiffeisen Invest”, me çmim 111.41 euro/kuotë, në vlerë totale fondi 10,000 euro.

Në datën 26.5.2016 bashkëjetuesja ka kryer pagesën e ruajtjes së qelizave staminale në vlerën 2,300 euro, me nr. fature \*\*\*\*\*, lëshuar nga “C.S.AG”.

**Tabela nr. 13** – analiza financiare për mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* në vitin 2016

	<b>Viti 2016</b>
<b>Pasuria</b>	<b>557,289.72</b>
<i>Ndryshim likuiditeti (shitesa/pakësime)</i>	557,289.72
Likuiditete	13,790,180.75
<b>Pasuri neto</b>	<b>557,289.72</b>
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	<b>3,565,768.41</b>
Të ardhura të subjektit	1,310,196.00
Të ardhurat e bashkëjetueses	2,081,464.00
Të ardhura nga sig. barrë lindje	162,715.00
Të ardhura nga interesat bankare	11,393.41
<b>Shpenzime</b>	<b>1,187,351.50</b>
Shpenzime jetike	842,413.00
Shpenzime (blerje) me kartë krediti, znj. L. B	410,536.33
Shpenzime për ruajtjen e qelizave staminale	344,938.50
<b>Mundësia për kursim</b>	<b>1,410,590.86</b>

**31.1.** Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëjetuesja e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për kursimet *cash* në shumën 450,000 lekë.

**31.2.** Në përfundim, konkludohet se bashkëjetuesja e subjektit ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare për të krijuar gjendjen *cash* në shumën 450,000 lekë.

**32. Depozitë bankare “K”<sup>44</sup>** për A. B në vitin 2014, në vlerën 20,000 lekë

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** subjekti nuk ka deklaruar burim.

### **Hetimi<sup>45</sup>/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni**

Bazuar në shkresën nr. \*\*\*, datë 3.3.2020, të “Credins Bank” rezulton se në datën 4.3.2014 është çelur depozitë nr. \*\*\* në emër të A. B, me afat 204-mujor, me interes vjetor 4.15%. Shuma e kësaj depozite rezulton 20,000 lekë. Subjekti Endrit Bimi dhe znj. L.K janë titullarë të kësaj llogarie bankare. Komisioni konkludon se nuk ka dyshime apo paqartësi për këtë depozitë.

**33. Në përfundim të hetimit Komisioni ka kryer analizën financiare për subjektin.**

**33.1.** Në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se ka filluar bashkëjetesën me shtetasen L. K në vitin 2013. Ai ka deklaruar gjithashtu se shpenzimet kanë qenë të përbashkëta, me mirëkuptim, sipas mundësive.

**33.2.** Nga hetimi rezultoi se fitimi pas zbritjes së tatimit mbi fitimin nga aktiviteti privat “klinikë dentare” e shtetasës L.K ka qenë, si më poshtë vijon:

- 287,503 lekë për vitin 2014;
- 1,194,322 lekë për vitin 2015;
- 3,200,000 lekë për vitin 2016.

**33.3.** Në DVP/2016 shtetasja L. K, në rubrikën “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, ka deklaruar: “*Fitimi vjetor për vitin 2016 nga puna si mjekë*”

<sup>44</sup> Subjekti ka paraqitur kontratë depozite, datë 4.3.2014, lidhur me “Credins Bank”.

<sup>45</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, dërguar QKB; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2020, e QKB-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2020, e DRT-së Tiranë.

*stomatologe në biznesin privat familjar (bashkëlidhur kuponit periodik tatimor nxjerrë nga kasa me xhiro vjetore 4,549,300 lekë), fitimi i vitit 2016 është 3,200,000 lekë, nga të cilat një pjesë e ka përfituar babai im stomatolog dhe pjesën tjetër unë si individ”. Shuma e të ardhurave neto është 1,900,000 lekë. Në analizën financiare për vitin 2016 është konsideruar si e ardhur nga aktiviteti klinikë dentare shuma 1,900,000 lekë, e deklaruar nga shtetasja L. K.*

**Tabela përmbledhëse mbi mundësinë financiare të subjektit nga fillimi i detyrës**

	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	TOTAL	DPV/2017
<b>Pasuria</b>	<b>2,484,549.94</b>	<b>103,251.75</b>	<b>259,865.00</b>	<b>128,943.07</b>	<b>218,187.38</b>	<b>-122,293.56</b>	<b>706,050.06</b>	<b>5,039,987.57</b>	<b>2,616,876.09</b>	<b>2,047,473.72</b>	<b>557,289.72</b>	<b>14,811,335.75</b>	<b>33,851.49</b>
Automjet Mercedes-Benz								771,155.00				771,155.00	
Automjet Wolkswagen Golf 3		250,000.00										250,000.00	
<i>Ndryshim likuiditeti (shitesa/pakësime)</i>	2,484,549.94	-146,748.25	259,865.00	128,943.07	218,187.38	-122,293.56	706,050.06	5,039,987.57	2,616,876.09	2,047,473.72	557,289.72	13,790,180.75	33,851.49
Likuiditete	2,484,549.94	2,337,801.69	2,597,666.69	2,726,609.75	2,944,797.14	2,822,503.58	3,528,553.64	8,568,541.21	11,185,417.31	13,232,891.03	13,790,180.75		
<b>Detyrime</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuri neto (1-2)</b>	<b>2,484,549.94</b>	<b>103,251.75</b>	<b>259,865.00</b>	<b>128,943.07</b>	<b>218,187.38</b>	<b>-122,293.56</b>	<b>706,050.06</b>	<b>5,039,987.57</b>	<b>2,616,876.09</b>	<b>2,047,473.72</b>	<b>557,289.72</b>	<b>14,040,180.75</b>	<b>33,851.49</b>
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	<b>2,544,392.64</b>	<b>835,197.31</b>	<b>824,059.86</b>	<b>927,782.39</b>	<b>951,813.54</b>	<b>848,329.98</b>	<b>1,022,766.00</b>	<b>5,605,381.51</b>	<b>3,022,906.74</b>	<b>2,732,855.14</b>	<b>3,565,768.41</b>	<b>22,881,253.53</b>	<b>131,229.36</b>
Të ardhura të subjektit	208,566.00	798,766.00	816,324.00	918,437.00	943,571.00	843,903.00	1,022,766.00	889,098.00	1,203,728.00	1,309,316.00	1,310,196.00	10,264,671.00	92,464.55
Të ardhurat të bashkëjetueses								12,806.00	407,707.00	1,379,650.00	2,081,464.00	3,881,627.00	15,444.00
Të ardhura nga sig. barrë lindjeje											162,715.00	162,715.00	
Të ardhura nga interesat bankare	30,337.27	36,431.31	7,735.86	9,345.39	8,242.54	4,426.98	0.00	84,219.33	61,471.74	43,889.14	11,393.41	297,492.98	23,320.81
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme								150,000.00				150,000.00	
Të ardhura prike								4,469,258.18	1,350,000.00			5,819,258.18	
Likuiditete para detyrës	2,305,489.37											2,305,489.37	
<b>Shpenzime</b>	<b>51,389.25</b>	<b>261,958.38</b>	<b>437,729.24</b>	<b>460,515.38</b>	<b>664,235.60</b>	<b>376,620.00</b>	<b>283,344.00</b>	<b>496,091.18</b>	<b>868,131.81</b>	<b>672,828.00</b>	<b>1,187,351.50</b>	<b>5,760,194.32</b>	<b>79,351.35</b>
Shpenzime jetike	27,389.25	136,620.00	136,620.00	136,620.00	136,620.00	136,620.00	139,548.00	399,568.00	659,994.00	672,828.00	842,413.00	3,424,840.25	79,351.35
Udhëtime jashtë vendit (TIMS)	0.00	29,338.38	61,109.24	83,895.38	287,615.60	0.00	43,796.00	96,523.18	208,137.81	0.00	0.00	810,415.57	
Udhëtime për punë brenda vendit	24,000.00	96,000.00	240,000.00	240,000.00	240,000.00	240,000.00	100,000.00					1,180,000.00	
Shpenzime (blerje) me kartë krediti, znj. L. B											410,536.33		
Shpenzime për ruajtjen e qelizave staminale											344,938.50	344,938.50	
<b>Mundësia për kursim</b>	<b>8,453.46</b>	<b>469,987.18</b>	<b>126,465.63</b>	<b>338,323.95</b>	<b>69,390.56</b>	<b>594,003.54</b>	<b>33,371.94</b>	<b>69,302.76</b>	<b>-462,101.17</b>	<b>12,553.42</b>	<b>1,410,590.86</b>	<b>3,080,878.45</b>	<b>18,026.52</b>

**33.4.** Nga analiza financiare si më sipër ka rezultuar se subjekti ka qenë në pamundësi mjetesh financiare për vitin 2014 në shumën 462,101.17 lekë, duke iu kaluar barra e provës.

**33.5.** Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka prapësuar se janë dy rrethanat që kanë sjellë këtë rezultat negativ:

- i. Së pari, bashkëjetuesja e tij gjatë viteve 2013 dhe 2014 ka pasur në “Raiffeisen Bank” shumën 24,040 USD. Kjo shumë, e konvertuar me kursin e datës 31.12.2013, ku 1 USD këmbëhet me 102,38 lekë, është e barabartë me 2,461,215 lekë. E njëjta shumë e konvertuar me kursin e datës 31.12.2014, ku 1 USD këmbëhet me 113,64 lekë, është e barabartë me 2,731,906 lekë. Pra, subjekti pretendon një diferencë nga kursi i konvertimit në shumën 270,691 lekë.
- ii. Së dyti, gjatë vitit 2014, duke qenë se vajza e subjektit të rivlerësimit ka qenë rreth 1 vjeç dhe bashkëjetuesja e tij duhet të rikthehej në punë, ajo e ka dërguar vajzën për përkujdesje tek nëna e saj, e cila e kishte shtëpinë ngjitur me klinikën dentare. Duke qenë se prindërit e bashkëjetueses kanë qenë në gjendje të mirë financiare, ata kanë mbuluar të gjitha shpenzimet e vajzës. Kështu, gjatë vitit 2014 subjekti pretendon të ketë pasur shpenzime jetese për dy persona, të cilat, sipas standardit të përdorur nga Komisioni janë në shumën totale 439,996 lekë.

**33.6.** Komisioni vlerësoi provat dhe shpjegimet e subjektit. Në lidhje me diferencën e rezultuar nga përllogaritja e kursit të këmbimit, Komisioni vlerëson të pranojë pretendimet e subjektit, duke kryer sistemimet përkatëse në analizën financiare. Në lidhje me pretendimin e subjektit për mospërfshirjen e shpenzimeve jetike të vajzës së tij në analizën financiare të vitit 2014, Komisioni vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk është i mbështetur në prova dhe fakte, për rrjedhojë, nuk do të merret në konsideratë. Komisioni, pasi kreu edhe një herë analizën financiare, i rezulton se subjekti ka qenë në pamundësi mjetesh financiare për vitin 2014 në shumën 123,611.66 lekë.

## **KONSTATIME TË TJERA**

### **34. Në lidhje me vendbanimin e subjektit të rivlerësimit**

#### **Konstatimi i ILDKPKI-së**

- *Në deklaratat e interesave private ndër vite dhe në deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar adresën “Njësia Bashkiake nr. 7, Rr.K, pallati nr. \*\*\*, shk. \*, ap. \*\*, Tiranë. Nuk është e qartë marrëdhënia juridike që ka subjekti me këtë adresë, pasi nuk ka deklaruar në pronësi, përdorim apo dhe me qira, pasuri të paluajtshme në emër të tij dhe bashkëjetueses.*

**34.1.** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: “[...] kam lindur, kam banuar dhe banoj aktualisht në adresën: Rr. K, pallati nr. \*\*\*, shk. \*\*, ap. \*\*. Pronar i objektit, përfutur në bazë të ligjit ‘Për privatizimin’ është E. B, Sh.B dhe M B. Në korrik të vitit 2017 babai ndërroi jetë dhe për efekt trashëgimie ligjore unë përfitova 1/3 nga pjesa e tij”.

Subjekti ka deklaruar këtë adresë në të gjitha deklaratimet periodike, si dhe në formularin e kontrollit të figurës.

**34.2.** Komisioni hetoi në lidhje me apartamentin në të cilin subjekti ka banuar nga data e marrjes së detyrës dhe aktualisht. Nga hetimi i kryer rezultoi si vijon:

i) ASHK-ja<sup>46</sup> konfirmon se pasuria “apartament” me sip. 84.4 m<sup>2</sup> rezulton e regjistruar në emër të shtetasës Sh. B, e cila zotëron 4/9 pjesë takuese, shtetasit M.B, i cili zotëron 4/9 pjesë takuese dhe shtetasit Endrit Bimi, i cili zotëron 1/9 pjesë takuese.

<sup>46</sup> Aplikim i kryer në portalin e ASHK-së; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2021.



Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të kësaj pasurie rezulton se në origjinën e tij apartamenti është përfituar përmes procesit të privatizimit, sipas kontratës së privatizimit<sup>47</sup> të lidhur mes shtetasit E. B dhe NK Banesa, kundrejt çmimit 26,096 lekë dhe është regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve E, Sh e M. B.

ii) Noteri publik<sup>48</sup> A.H ka vënë në dispozicion kopje të vendimit nr. \*\*\* për “lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore”, datë 30.10.2017, për të ndjerin E. B. Sipas kësaj dëshmie, trashëgimlënësi ka ndërruar jetë në datën 5.7.2017 dhe nuk rezulton të ketë disponuar pasurinë e tij me testament. Në këto kushte, trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të shtetasit E.B janë bashkëshortja Sh.B dhe dy fëmijët e tij, M dhe E.B, të cilët trashëgojnë 1/3 pjesë takuese të pasurisë trashëgimore, ku përfshihet edhe apartamenti nr. \*\*, i ndodhur në Rrugën e Kavajës.

**34.3.** Komisioni arrin në konkluzionin se nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë pasuri.

### **35. Tërheqja e shumës 702,460 lekë në BKT, si pjesë takuese e trashëgimisë**

**35.1.** Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se në datën 7.5.2019 subjekti ka tërhequr nga llogaria bankare e shtetasit E. B (babai i tij) pranë BKT-së shumën 702,460 lekë, me përshkrimin “Endrit Bimi tërheq pjesën takuese pas dëshmisë së trashëgimisë, datë 30.7.2017, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.”.

**35.2.** Në lidhje me këtë shumë, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: *“Në datën 7 maj 2019 kam kryer veprime formale të tërheqjes së shumës takuese prej 702,460 lekësh, të cilat i kam kthyer/depozituar në të njëjtën ditë në llogarinë e mamasë si pasuri që i takon prindit. Prindi më ka bërë me dije se burimi i kësaj pasurie është pjesë e të ardhurave të kredituara në banka, nga zyra përmbarimore ‘A’ sh.p.k., për llogari të prindërve që ka shlyer borxhin që ka pasur ndaj tyre”.*

Si arsye për kryerjen e këtij veprimi bankar subjekti ka sqaruar: *“Në vitin 2019 mamaja më ka bërë me dije se në bankën BKT nuk e kanë lejuar që të bëjë veprime në llogarinë e saj, sepse në atë llogari rezultonte edhe emri i babait që ka ndërruar jetë në korrik të vitit 2017. Në këto kushte, mamasë i është bërë me dije që banka, për të vijuar veprimet bankare me të, ka kërkuar miratimin tim dhe të vëllait, si detyrim ligjor që sipas bankës rrjedh për shkak të të qenit trashëgimtarë ligjorë të tij”.*

**35.3.** Në kushtet kur 1/3 pjesë e fondeve<sup>49</sup> të përfituara nga prindërit e subjektit përmes procesit përmbarimor, është trashëguar nga subjekti, sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. \*\*\*, datë 30.10.2017, Komisioni ka hetuar në lidhje me burimin e ligjshëm të këtyre fondeve. Nevoja e hetimit lindi gjithashtu edhe si pasojë e dy denoncimeve<sup>50</sup> të mbërritura pranë Komisionit, sipas të cilëve pretendohet se subjekti i rivlerësimit, në bashkëpunim me administratorin e zyrës përmbarimore “A” sh.p.k., ka shitur shtëpinë e denoncuesve pa zbatuar rregullat e zhvillimit të ankandit.

**35.4.** Komisioni ka administruar nga zyra përmbarimore “A” sh.p.k. dosjen e plotë të çështjes përmbarimore, nga shqyrtimi i së cilës ka rezultuar se:

<sup>47</sup> Kontrata e privatizimit nuk përmban datë. Në kartelën e pasurisë së pronës gjendet shënimi “nuk ka kontratë shitje”.

<sup>48</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2021, drejtuar noterit publik A. H; shkresë kthim përgjigje datë 24.5.2021.

<sup>49</sup> Vlera totale e kredituar në llogarinë bankare të shtetasit E. B nga zyra përmbarimore “A” sh.p.k. është 4,161,365 lekë.

<sup>50</sup> Denoncimet e shtetasve H dhe R. B, njëkohësisht palë debitore në procesin përmbarimor.

i) Shtetasi italian R.S dhe shtetasi R.B kanë pasur marrëdhënie ortakërie në shoqërinë “A. sh” sh.p.k. Për shkak të mosmarrëveshjeve të tyre shtetasi R.S i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë me objekt “detyrimin e palës së paditur R. B për kthimin e shumës 16,792.157 lekë”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit kanë vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, datë 16.9.2009. Në këto procese gjyqësore, paditësi R. S është përfaqësuar me prokurë nga babai i subjektit, z. E. B.

ii) Në datën 9.5.2013 shtetasi E.B, në cilësinë e përfaqësuesit<sup>51</sup> të shtetasit R.S, ka depozituar kërkesën për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit pranë zyrës përmbartimore “A” sh.p.k. Kjo e fundit ka vijuar me kryerjen e veprimeve përmbartimore deri në sekuestrimin e pasurisë së debitorit, veçimin e pjesës takuese të tij dhe shitjen e saj në ankand në datën 26.10.2015, në vlerën 6,950,000 lekë në favor të shtetasit R.Y. Nga kjo shumë, vlera 2,196,667 lekë ka kaluar në favor të bashkëpronarit të pasurisë së veçuar, në përputhje me vendimin gjyqësor për përcaktimin e pjesëve takuese të secilit bashkëpronar.

iii) Sipas nxjerrjes së llogarisë bankare të shoqërisë “A” sh.p.k., të ndodhur në dosjen përmbartimore, rezulton se në datën 30.10.2015 kjo shoqëri ka transferuar në favor të shtetasit E.B shumën 4,161,365 lekë<sup>52</sup>, me përshkrimin “‘A’ sh.p.k. kalon për E ose Sh.B sipas procesverbalit të ankandit”.

Në lidhje me shumën e kredituar nga kjo zyrë përmbartimore në favor të babait të tij, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar: *“Dijeninë për këtë marrëdhënie e kam nga aktet që ka lënë babai. Sipas akteve rezulton se në vitet 1993 - 1194 z. S krijon një shoqëri fasonerie në Shqipëri, në të cilën ka kontribuar edhe babai, duke i dhënë borxh 45,000 dollarë amerikanë. Në vitin 1995 z. S largohet në Itali dhe nuk vjen më në Shqipëri, pasi po procedohej penalisht në Itali për dhënie parash me fajde, duke lënë në Shqipëri borxhe të pashlyera dhe biznesin në kushte të vështira. Shoqëria dhe të ardhurat e saj u përvetësuan në mënyrë të paligjshme nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve nga R.B, për çka është dënuar me vendim të formës së prerë nr. \*\*\*, datë 20.3.2006, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Duke qenë se z. B përvetësoi shoqërinë dhe të ardhurat e saj në mënyrë të paligjshme, z. S autorizoi me akt noterial babain që të ndiqte këtë problem në rrugë ligjore, për çka e ka marrë përsipër ta ndiqte me dekada të tëra këtë çështje, pasi kishte premtimin dhe besimin që z. S me të ardhurat e shoqërisë do të shlyente borxhin ndaj babait, që sipas vendimit gjyqësor civil që ka deklaruar fajtor z. B, është rreth 16,900,000 lekë”.*

Subjekti, së bashku me pyetësorin, ka bashkëlidhur:

- Kopje të procedimit penal nr. \*\*, regjistruar në datën 13.2.2019, mbi bazë të kallëzimit penal të kryer nga shtetasi E. B kundër të pandehurit R.S, për veprën penale të “mashtimit”, në përfundim të të cilit Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq.
- Kopje të vendimit nr. \*\*/2015, datë 13.5.2015, të Gjykatës së Kontrollit Fiskal të Republikës së Italisë, nga përmbajtja e të cilit evidentohet se shtetasi R. S është hetuar për kryerjen e veprës penale të “mashtimit”.
- Marrëveshje për njohje detyrimi dhe premtim dhënie kuotash lidhur në datën 17.3.1995 mes shtetasve R.S, R.B dhe E.B.
- Deklaratë e nënshkruar nga shtetasi R.S në datën 8.2.2000, përmes së cilës njeh dhe pranon detyrimin ndaj z. E.B në shumën rreth 45,000 dollarë amerikanë.

<sup>51</sup> Përfaqësuar përmes prokurës së përgjithshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.7.1999 dhe prokurës së posaçme hartuar në Itali, me nr. regjistri \*\*\*, datë 11.2.2000. Këto dy prokura janë konfirmuar si të ligjshme dhe me vendim nr. \*\*\*, datë 23.6.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

<sup>52</sup> Referuar vendimit gjyqësor detyrimi total i debitorit B ndaj R.S është në vlerën 17,579.380. Por nga procesi përmbartimor është arritur të ekzekutohet vlera 4,161,365 lekë.

- Shkresë e thjeshtë e nënshkruar nga shtetasi R.S në datën 8.2.1995, në përmbajtje të së cilës citohet detyrimi që ky shtetas ka ndaj z. E. B.
- Shkresa të thjeshta të dërguara me fax nga R. S drejt R. B, në të cilat citohet detyrimi i R. S ndaj z. E.B.
- Vendim datë 2.6.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse E. B dhe të paditur R.S, me objekt “detyrimin e të paditurit për kthimin e shumës 45,000 USD dhe kamatat përkatëse etj.”. Sipas vërtetimit që shoqëron këtë vendim, çështja ndodhet për gjykim në Gjykatën e Lartë.

**35.5.** I pyetur nga Komisioni nëse ka hetuar/proceduar shtetasin B. N apo shoqërinë “A” sh.p.k., subjekti ka deklaruar se: *“Në gjysmën e dytë të vitit 2016 kam pasur një çështje të hetuar nga prokurorja D.S, e cila dha dorëheqjen për shkak se është kallëzuar nga përmbaruesi B. N për një çështje tjetër të saj ndaj përmbaruesit, përpara fillimit të këtij procedimi. Kjo çështje është pushuar për shkak se fakti nuk përbënte vepër penale. Ky vendim pushimi është kundërshtuar në gjykatë dhe është lënë në fuqi në të dy shkallët e gjyqimit. Në vitin 2018 kam vendosur mosfillimin e procedimit penal mbi kallëzimin e bërë nga B. N, si të pa mbështetur në ligj”.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti lidhur me këto procedime penale rezulton se:

**i.** Në vitin 2016, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazë të kallëzimit penal të shtetasit M.V, është regjistruar procedimi penal në ngarkim të shtetasit B.N, për konsumimin e veprës penale “shpërdorim detyre”. Mbështetur në rrethanat e konfliktit, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit, duke argumentuar se pretendimet e kallëzuesit nuk janë të karakterit penal dhe, për rrjedhojë, nuk ka vend për përgjegjësi penale. Nga aktet e vëna në dispozicion nga subjekti rezulton se kallëzuesi i është drejtuar gjykatës duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të pushimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

**ii.** Në vitin 2018, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur kallëzim shtetasi B. N, i cili ka pretenduar se ka humbur aparatin e tij celular në rrethana të paqarta. Subjekti ka argumentuar se nga deklaratimet e kallëzuesit rezulton se ai ka humbur telefonin, pra nuk rezulton se ia kanë vjedhur. Në këto kushte, duke argumentuar se fakti i kallëzuar nuk përbën vepër penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

**35.6.** Pas analizimit të dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, në mbledhjen e datës 15.10.2021, vlerësoi se:

- Kreditimi i shumës 45,000 USD në llogarinë bankare të babait të subjektit është i bazuar në marrëdhënien kontraktuale të krijuar mes tij dhe shtetasit R.S.
- Shtetasi E.B ka lidhur kontratë shërbimi me shoqërinë “A” sh.p.k. në datën 9.5.2013, në bazë të së cilës, më 30.10.2015 kjo shoqëri ka transferuar në favor të z. B shumën 4,161,365 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka hetuar administratorin e kësaj shoqërie në vitin 2016, periudhë e cila është më e vonshme se ekzekutimi i vendimit nga përmbaruesi.

Në nenin 26/1 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *“Prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie për rastet e parashikuara nga neni 17”.*

Në nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *“1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete:*

*a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit ose i fëmijëve të tij;*

b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërit nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërit prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij;

c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit;

ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërin prej palëve private;

d) kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale;

dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim;

e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16;

ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”.

Referuar bazës ligjore të mësipërme rezulton se subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin B.N, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale, për të cilat duhej të hiqte dorë nga procedimi.

Komisioni vlerëson se pavarësisht faktit se babai i subjektit ka fituar të drejtën e tij me vendimin datë 2.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>53</sup>, me palë paditëse E.B dhe të paditur R.S, me objekt “detyrimin e të paditurit për kthimin e shumës 45,000 USD dhe kamatat përkatëse”, veprimet e kryera prej tij për të përfituar shumën 4,161,365 lekë (e cila është me e vogël se shuma 45.000 USD) duket se janë bërë në tejkalim të tagrave të përfaqësimit. Këto veprime të babait të subjektit nuk mund të përbëjnë shkak për rivlerësimin e pasurisë së subjektit, për sa kohë nuk ka qenë palë në këto procese, si dhe nga ana e tij shuma e tërhequr në datën 7.5.2019 nga llogaria bankare e shtetasit E.B (babai i tij) në BKT, në vlerën 702,460 lekë, është depozituar në po të njëjtën datë në llogarinë e nënës së tij me emërtim “Endrit Bimi depoziton në llogari të nënës pjesën takuese të trashëguar sipas vendimit të trashëgimisë”.

### **36. Blerja e apartamentit nga nëna e subjektit, znj. Sh. B, në datën 7.5.2019**

**36.1.** Nga hetimi i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 7.5.2019, nëna e subjektit Sh. B ka blerë nga shitësit E e G.Gj “apartament” me sip. 83 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “Mine Peza”, Tiranë, për çmimin 95,000 USD. Ky çmim është derdhur në llogarinë bankare të noterit në BKT. Referuar fragmentit të llogarisë bankare të noterit A. H transferimi i këtyre fondeve në llogarinë e noterit është bërë përmes llogarisë bankare të palës blerëse Sh.B.

**36.2.** Në lidhje me këtë pasuri, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar: “Apartamenti është blerë nga mamaja dhe vëllai në vitin 2019 me të ardhurat e vëllait dhe të mamasë, sipas statement-it bankar bashkëngjitur. Apartamenti, që nga momenti i blerjes, nuk është përdorur, sepse vëllai kishte vendosur ta rregullonte kur të vinte me pushime në Shqipëri, por për arsye të pandemisë ai ndaloi investimin për ta rregulluar dhe për momentin është i pabanueshëm. Unë nuk kam asnjë kontribut financiar në blerjen e këtij apartamenti. Më poshtë statementet bankare që vërtetojnë që ky apartament është blerë me të ardhurat e vëllait dhe të prindit”.

<sup>53</sup> Aktualisht çështja ndodhet për gjykim në Gjykatën e Lartë.

Ky deklaram i subjektit përputhet edhe me lëvizjet bankare të kryera përpara blerjes së këtij apartamenti, nga ku rezulton se në datën 6.5.2019 shtetasi M.B ka transferuar shumën 14,975 USD në llogarinë e shtetases Sh.B.

**36.3.** Sa i përket çmimit të blerjes rezulton se ai është paguar nëpërmjet sistemit bankar, ku si burim ka shërbyer:

- i. shuma 4,214,742.60 lekë, e përfituar nga shtetasi E.B në datën 30.10.2015;
- ii. gjendjet e llogarive bankare të shtetasit E.B në “Credins Bank” dhe “FiBank”, të krijuara nga viti 2004 dhe të investuara në bono në Bankën e Shqipërisë deri në vitet 2014 dhe 2015, ku më pas janë depozituar në llogarinë e përbashkët të shtetasve Sh dhe E.B në “Credins Bank”, përkatësisht shuma 720,255 lekë në vitin 2014 dhe shuma 1,300,000 lekë në vitin 2015;
- iii. gjendje e llogarive bankare në “FiBank” të shtetases Sh. B, përkatësisht në shumat 11,986 euro dhe 1,183,500 lekë, krijuar në vitin 2012, me burim dërgimin e parave nga shtetasi M.B.

**36.4.** Në lidhje me burimin e ligjshëm të depozitave të mësipërme, në përgjigje të pyetësorit të datës 22.6.2021, subjekti ka deklaruar: *“Nga biseda me mamanë dhe vëllain më është bërë me dije që këto depozita kanë si burim të ardhurat nga punësimi i vëllait M. B në Kanada dhe USA. Këto shuma monetare janë sjellë personalisht nga vëllai, si dhe nëpërmjet personave të tretë që udhëtonin për në Shqipëri”*.

Për të vërtetuar të ardhurat dhe mundësitë financiare të vëllait të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacion provues:

- i. vërtetim mbi tatimin nga të ardhurat, lëshuar nga Agjencia e të Ardhurave Kanada për vitet tatimore 2001, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2007, nga ku rezulton se të ardhurat e shtetasit M. B janë në total 122,083.18 CAD (10,367,588.55 lekë);
- ii. deklaratë e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga Social Security Administration në datën 22.6.2021, për periudhën e punësimit të siguruar 2007 – 2020, nga ku rezulton se të ardhurat për këtë periudhë janë 429,135 USD (46,150,940.21 lekë).

**36.5.** Komisioni ka kryer një analizë financiare për mundësitë e vëllait të subjektit për t’u dërguar prindërve të tij shumat që kanë shërbyer për hapjen e depozitave, përkatësisht shumën 700,000 lekë në vitin 2004 në BKT, shumat 1,300,000 lekë dhe 750,500 lekë në vitin 2009 në “Societe Generale Bank”, si dhe shumat 11,000 euro dhe 1,000,000 lekë në vitin 2011 në “FiBank”.

Nga analiza financiare rezulton se vëllai i subjektit M.B ka pasur mundësi financiare për të dërguar shumat e mësipërme tek prindërit e tij.

**Tabela nr. 14** – analiza financiare me të ardhurat nga punësimi në shtetin kanadez dhe nga punësimi në USA

<b>Të ardhurat e z. M. B në lekë<sup>54</sup></b>	<b>Të ardhura nga Kanadaja, vitet 2001 - 2006</b>	<b>Të ardhurat nga USA, vitet 2007 - 2016</b>
Të ardhura <i>neto</i> në USA	0.00	26,336,267.93
Të ardhura <i>neto</i> në Kanada	6,546,662.05	0.00
<b>Totali, të ardhura</b>	<b>6,546,662.05</b>	<b>26,336,267.93</b>
<b>Dërgesat në Shqipëri</b>	<b>700,000.00</b>	<b>4,588,720.00</b>

<sup>54</sup> Për të ardhurat në USD dhe CAD referohuni analizës financiare bashkëlidhur vendimit. Shpenzimet jetike në analizë janë konsideruar duke iu referuar burimit 1. “Statistics Canada, Survey of Household Spending” <https://ic.gc.ca/eic/site/oca-bc.nsf/eng/ca02117.html#a91>; 2. <https://lni.wa.gov/workers-rights/wages/minimum-wage/history-of-washington-states-minimum-wage>

<b>Mundësia për kursime</b>	<b>5,846,662.05</b>	<b>21,747,547.93</b>
<b>Mundësia kumulative për kursime</b>	<b>5,846,662.05</b>	<b>27,594,209.98</b>

**Tabela nr. 15** – analiza financiare e familjes së subjektit për vitet 1989 - 2016

	<b>Kumulative 1989-2016</b>
<b>Pasuria</b>	<b>9,049,183.10</b>
Apartament përfituar nga privatizimi	-
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>9,049,183.10</i>
<b>Detyrime</b>	<b>-</b>
<b>Pasuri neto (1-2)</b>	<b>9,049,183.10</b>
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	<b>18,076,456.79</b>
Të ardhurat e babait	2,950,976.69
Të ardhurat e nënës	4,980,181.11
Të ardhurat e vëllait nga puna në Shqipëri	711,484.00
Të ardhurat nga puna në emigracion	5,288,720.00
Të ardhura nga "A" sh.p.k.	4,161,365.00
<b>Shpenzime</b>	<b>6,414,969.50</b>
Shpenzime jetike	6,414,969.50
<b>Mundësia për kursim (B-A)</b>	<b>2,612,304.19</b>

**36.6.** Trupi gjykues, në mbledhjen *online* të datës 15.10.2021, në prani edhe të vëzhguesit ndëkombëtar, me shumicë votash, vlerësoi të mos i kalojë subjektit barrë prove në lidhje me këtë apartament, pasi nuk është provuar që të ketë një interes pasuror (marrëdhënie dhurimi, huamarrjeje ose huadhënieje) ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij në lidhje me këtë apartament banimi, për rrjedhojë, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>55</sup>, ai nuk është i detyruar të provojë burimin e ligjshëm të kësaj pasurie e cila, për më tepër, është krijuar tre vjet pas plotësimit të deklaratës *Vetting*.

Bazuar në kuadrin ligjor që normon procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, si dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>56</sup>, subjektet e rivlerësimit mbajnë përgjegjësi për saktësinë, vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve dhe gjendjes së pasurisë, deri në dorëzimin e deklaratës *Vetting*.

Ky qëndrim i Komisionit bazohet edhe në vendimin nr. 26, datë 4.8.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ku shprehet se: *“Në analizë të kësaj situatë faktike dhe ligjore, Kolegji sjell në vëmendje jurisprudencën<sup>57</sup> e tij, ku arsyetohet se parashikimet e nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, shërbejnë për të përcaktuar rrethin e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit në kontekst më të gjerë, si në funksion të deklaramit e verifikimit të çdo situatë të mundshme të konfliktit të interesit, pjesë gjithashtu e detyrueshme për kontroll si nga ILDKPKI-ja (shihni nenin 33, pika 5, germa ‘d’ e ligjit nr. 84/2016), ashtu edhe nga vetë organet e rivlerësimit, edhe në funksion të përcaktimit të detyrimit të subjekteve të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.*

*Ky detyrim i subjektit të rivlerësimit rezulton i qartë, përcaktuar në rrethana të veçanta, kur këta persona të tjerë të lidhur të kenë si elemente të detyrueshme në marrëdhënien me subjektin e rivlerësimit, një marrëdhënie huaje apo dhurimi, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit*

<sup>55</sup> Vendime nr. \*\*, datë 10.9.2020 dhe nr. \*\*, datë 24.6.2020.

<sup>56</sup> Vendim nr. \*\*, datë 9.3.2021.

<sup>57</sup> Vendim nr. 15/2019 (JR), datë 17.7.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafët 107, 108 dhe 109; vendim nr. 20/2019 (JR), datë 8.9.2020, paragrafi 21.3; vendim nr. 36/2020, datë 16.12.2020, paragrafi 21.8.

nr. 84/2016. Pra, në këndvështrim të Kolegjit, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera, pasuria e personave të tjerë të lidhur duhet të jetë objekt verifikimi, legjitimuar nga ekzistenca e dyshimeve për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo ekzistencës së një konflikti të mundshëm interesi.

Në këto kushte, pavarësisht disa rrethanave të konstatuara në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament banimi në pronësi të vëllezërve të subjektit të rivlerësimit, Kolegji arsyeton se nuk mund të merren në analizë të ardhurat e vëllait të subjektit të rivlerësimit në rastin konkret, pasi nuk është në rrethin e personave të tjerë të lidhur, siç u sqarua më lart, si dhe të gjendur në kushtet e mungesës së dyshimeve për konflikt të mundshëm interesi apo pasuri të fshehura pas hetimit të thelluar të kryer nga Komisioni, vlerësohet se verifikimi i mëtejshëm i tyre do të kapërcente kufijtë e objektit të procesit të rivlerësimit... ”.

Megjithëse kjo pasuri është krijuar pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*, Komisioni hetoi dhe me shumicë ka konkluduar se nuk jemi në kushtet e pasurisë së fshehur.

### **37. Blerja e apartamentit nga babai i bashkëjetueses të subjektit, z. A. K, në datën 19.6.2019**

**37.1.** Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 19.6.2017, babai i bashkëjetueses së subjektit ka blerë nga shitësit P e F.Xh apartament me sip. 154 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, ndodhur në rrugën “Mine Peza”, Tiranë, për çmimin 17,290,000 lekë.

Sipas përmbajtjes së kontratës së shitjes, shuma 17,000 euro është likuiduar sipas mandatit bankar datë 11.5.2017, ndërsa shuma 113,000 euro do të kalojë nëpërmjet llogarisë së noteres në “Alpha Bank”.

**37.2.** Sa i përket çmimit të blerjes së apartamentit, nga nxjerrjet e llogarive bankare të babait të bashkëjetueses së subjektit, rezultoi se:

- a) Pagesa 17,000 euro është likuiduar nga shtetasi A. K nëpërmjet llogarisë së tij në “Alpha Bank” në datën 11.5.2017, me përshkrimin “Kalim nga A.K tek E.G and G. Xh and F.Xh and P.Xh, kalim për blerje apartamenti, rruga ‘Mine Peza’, me sip. 154 m<sup>2</sup>, kapar për mbylljen e kredisë”.
- b) Në llogarinë e tij nr. \*\*\*-ALL-\*\*\* në “Raiffeisen Bank” janë kryer veprimet e mëposhtme:
  - në datën 11.5.2017 znj. L. K i transferon në llogari shumë prej 2,100,000 lekësh, nën përshkrimin “Kalim babait”;
  - në datën 16.5.2017 z. Endrit Bimi i transferon në llogari shumë prej 1,275,068.35 lekësh nën përshkrimin “Huadhënie”;
  - në datën 16.5.2017 nga “Raiffeisen Invest” i kalon në llogari shuma prej 2,236,063.10 lekësh, nën përshkrimin “Shlyerje sipas urdhrit ...”;
  - në datën 18.5.2017 z. Endrit Bimi i transferon në llogari shumë prej 3,000,000 lekë, nën përshkrimin “Hua”.

Gjendja e llogarisë në datën 21.6.2017 rezulton në vlerën 8,610,850.06 lekë, e cila, në po të njëjtën datë, konvertohet me 64,791.95 euro dhe transferohet nga llogaria nr. \*\*\*-EUR-\*\*\* e shtetasit A. K në “Raiffeisen Bank”.

- c) Bashkëjetuesja e subjektit, në datën 18.5.2017 ka transferuar në llogarinë e mësipërme të babait të saj në euro shumë prej 7,300 euro.

Gjendja e llogarisë në euro të shtetasit A. K në datën 21.6.2017 është 48,299.85 euro, të cilës i është shtuar edhe shuma e transferuar në po këtë datë prej 64,791.95 euro. Në datën 21.6.2017 shtetasi A.K transferon në llogarinë e noteres M. Sh vlerën 113,000.80 euro, nën përshkrimin “Kalim sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.6.2017, blerësi A. K”.

Në lidhje me këtë pasuri, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar: “*Sqaroj se z. A. K më bëri me dije se shumat e transferuara janë përdorur të gjitha për blerjen e një apartamenti në vitin 2017. Ky apartament nuk përdoret nga unë. Ky apartament përdoret nga z. A.K*”.

**37.3.** Trupi gjykues, në mbledhjen *online* të datës 15.10.2021, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, me shumicë votash vlerësoi të mos i kalojë subjektit barrë prove në lidhje me këtë apartament, pasi provoi që ai dhe bashkëjetuesja e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huave shtetasit A.K për blerjen e këtij apartamenti, duke përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 32 i ligjit nr. 84/2016.

Dhënia e huave babait të bashkëjetueses për blerjen e apartamentit nuk e bëjnë atë person të lidhur apo tjetër të lidhur në lidhje me apartamentin e blerë nga ana e tij, pasi nuk është provuar që të ketë një interes pasuror (marrëdhënie dhurimi, huamarrjeje ose huadhënieje) ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe babait të bashkëjetueses në lidhje me këtë apartament banimi, për rrjedhojë, subjekti, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>58</sup>, nuk është i detyruar të provojë burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, e cila për më tepër është krijuar pas plotësimit të deklaratës *Vetting*. Bazuar në kuadrin ligjor që normon procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, si dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>59</sup>, subjektet e rivlerësimit mbajnë përgjegjësi për saktësinë, vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve dhe gjendjes së pasurisë, deri në dorëzimin e deklaratës *Vetting*.

Qëndrimi i Komisionit bazohet edhe në vendimin nr. 26, datë 4.8.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si më sipër.

Megjithëse kjo pasuri është krijuar pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*, Komisioni hetoi dhe me shumicë votash konkludon se nuk jemi në kushtet e pasurisë së fshehur.

### **Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**38.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**38.1.** Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Endrit Bimi, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**38.2.** Siç u evidentua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe

<sup>58</sup> Vendimet nr. 21, datë 10.9.2020, dhe nr. 7, datë 24.6.2020.

<sup>59</sup> Vendim nr. 8, datë 9.3.2021.



reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve përkatëse.

**38.3.** Subjekti rezulton me një bilanc negativ në vitin 2014, në shumën 123,611.66 lekë, shumë e cila, në vlerësim të Komisionit, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e tyre, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se kjo mungesë të ardhurash, në këtë moment, nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61.

**38.4.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Endrit Bimi, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**39.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Endrit Bimi, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

**39.1.** Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin<sup>60</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Endrit Bimi, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**39.2.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

**39.3.** Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, z. Endrit Bimi, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

## **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**40.** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Endrit Bimi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI PROFESIONAL**

**41.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

---

<sup>60</sup> Raporti me nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017.

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; dhe
- denoncimet e paraqitura në Komision.

## **Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe analiza e Komisionit**

**42.** Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**42.1.** Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave të dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së.

**42.2.** Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; si dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

**42.3.** Nga shqyrtimi i tri dokumenteve ligjore të paraqitur nga subjekti, Komisioni nuk konstatoi problematika.

**42.4.** Nga studimi i pesë dosjeve hetimore të përzgjedhura me short, Komisioni ka konstatuar problematikë vetëm në dosjen nr. 5.

**42.4.1.** Dosja nr. 5 i përket aktit “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\* të vitit 2015”. Akti është i datës 16.5.2016, përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti, me cilësinë e prokurorit në Prokurorin ë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Procedimi penal nr. \*\*\* është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 12.2.2015, në emër të shtetases E. V. V, për veprën penale “refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram të rremë të pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal.

Në datën 11.9.2015 është bërë zëvendësimi i prokurorit, duke u caktuar me ndjekjen e hetimeve subjekti i rivlerësimit. Në datën 12.2.2016 subjekti ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. \*\*\* të vitit 2015, pasi argumenton se fakti i pretenduar nuk përmbush elementet e veprës penale. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 25.3.2016 ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të prokurorit të çështjes të datës 12.2.2016 dhe vazhdimin e hetimeve.

Komisioni ka konstatuar se pas këtij vendimi shfuqizimi subjekti, në datën 28.4.2016, pa kryer asnjë veprim hetimor, ka ngritur akuzë ndaj të pandehurës E.V, për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/1/2 i Kodit Penal dhe ka filluar procedurat e gjetjes së pandehurës pasi ajo nuk jetonte në Shqipëri. Lidhur me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me arsyet e ndryshimit të qëndrimit të tij me këtë çështje, pa kryer asnjë veprim të mëtejshëm hetimor.

**42.4.2.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka shpjeguar se *në rastin në fjalë, vendimi i prokurorit më të ulët është shfuqizuar nga prokurori më i lartë dhe në pjesën konstatuese të vendimit të shfuqizimit, në tre paragrafët e fundit të faqes nr. 8 të vendimit, ku citohet: “Nga veprimet*

hetimore, ka rezultuar se, referuar dokumentacionit të administruar konstatohet se veprimet e mëposhtme përmbushin elemente të veprës penale për çka ka filluar ky procedim”. Po ashtu, në faqen e fundit të vendimit të shfuqizimit, ku citohet: “Bazuar në provat e marra gjatë hetimeve, shtetasja E. V duhet të mbajë përgjegjësi penale dhe të dërgohet për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal”.

Përpara ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale organi i akuzës ka qenë organ i centralizuar, ku prokurori më i lartë kishte të drejtë të vendoste ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët dhe se urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë kanë qenë të detyrueshme. Nisur nga sa më sipër, rezulton se Drejtuesi i Prokurorisë ka konstatuar se veprimet hetimore dhe aktet e administruara kanë qenë të plota për të konkluduar me dërgimin e çështjes për gjykim. Neni 4/3 i ligjit të vjetër nr. 8737, datë 12.2.2001, përcaktonte se urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë jepen me shkrim të arsyetuara dhe të detyrueshme për prokurorin më të ulët. Në rastin në fjalë, rezulton se nuk ka pasur urdhërim për kryerje veprimesh hetimore, pasi hetimi i kryer ka qenë shterues.

**42.4.3.** Komisioni, me shumicë votash, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato janë bindëse dhe, për rrjedhojë, në lidhje me dosjen nr. 5 konstaton se subjekti ka arritur të japë argumente bindëse lidhur me paqartësinë e konstatuar nga Komisioni.

### **43. Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime**

**43.1.** Nga verifikimi në arkivën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nuk rezulton që subjekti, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të ketë masa disiplinore.

**43.2.** Nga përgjigjet nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para, rezultojnë disa kallëzime ose procedime në të cilët përmendet subjekti, si më poshtë vijon:

**i.** Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 4.9.2018 është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Shtetasi A.B ka bërë një kallëzim penal ndaj subjektit, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, A. P, me detyrë oficer i policisë gjyqësore pranë kësaj prokurorie, si dhe ndaj shtetasit B.S, me detyrë përmbartës privat, për veprat penale “shpërdorim detyre”, “pengim për ekzekutim të vendimeve të gjykatës”, si dhe “mosekzekutim pa shkaqe të përligjura të vendimit të gjykatës”, të parashikuara nga nenet 248,320 dhe 320/a të Kodit Penal.

Në përfundim të veprimeve hetimore, duke vlerësuar në tërësi aktet e këtij procedimi penal dhe deklaratimet e shtetasve, organi procedues nuk vëren elementë të veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe as elementë të ndonjë vepre tjetër penale dhe në mbështetje të germës “b” të pikës 1 të nenit 328 dhe neneve 329/a dhe 329/b të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur pushimin e procedimit.

**ii.** Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, me shkresën nr. \*\*\*, datë 27.1.2020 informon se subjekti i rivlerësimit është përmendur në kallëzimin penal nr. \*\* të vitit 2018, për të cilin, pas verifikimit, është vendosur mosfillim procedimi.

Shtetasi S.N, në datën 8.3.2018 ka paraqitur kallëzim ndaj subjektit të rivlerësimit Endrit Bimi, për veprën penale “shpërdorim detyre” dhe veprën penale “korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”. Për këtë kallëzim penal, pas verifikimeve të kryera, është vendosur mosfillim procedimi penal.

Pas ankimit të kallëzuesit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.6.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në lidhje me kallëzimin nr. \*\*\*, duke urdhëruar organin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme, si dhe lënien në fuqi të pjesës tjetër të vendimit. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.7.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë është vendosur ndryshimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 22.6.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe shfuqizimi i vendimit datë 6.4.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin nr. \*\* të vitit 2018.

Në vazhdim është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\* i vitit 2018, për nenet 248 dhe 319/ç të Kodit Penal. Pas kryerjes së hetimeve ky procedim është dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në datën 18.12.2019 dhe është në fazën e hetimit dhe deri tani nuk është regjistruar emri i shtetasit Endrit Bimi.

**iii.** Në datën 30.3.2018 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit S.Sh, është regjistruar materiali kallëzues nr. \*\*, i cili bën fjalë për veprën penale “korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Kallëzuesi S.Sh ka bërë kallëzim penal ndaj prokurorëve A.D dhe Endrit Bimi, duke pretenduar se këta funksionarë të drejtësisë, gjatë kryerjes së detyrës në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, kanë vendosur pushimin e çështjes penale nr. \*\*, të filluar mbi kallëzimin penal të bërë prej tij, pa asnjë motiv; kanë zvarritur hetimet; nuk e kanë thirrur për ta pyetur gjatë hetimit penal; nuk i kanë marrë parasysh dokumentet e pretenduara të falsifikuara; nuk kanë kryer hetime të plota ndaj të gjithë personave të kallëzuar.

Prokuroria, bazuar në germen “ç” të nenit 290/1 dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 18.4.2018 ka vendosur mosfillimin e hetimeve në lidhje me kallëzimin penal nr. \*\* të vitit 2018, për shkak se fakti nuk ekziston.

**43.2.1.** Në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme janë administruar disa ankesa në të cilat përmendet prokurori Endrit Bimi, si më poshtë vijon:

**i.** Ankesë e përsëritur nga shtetasi R. B. Ankesa e shtetasve R. B dhe H.B, protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 20.7.2012.

Në ankesën e tij ky shtetas shpjegon se ka një konflikt gjyqësor civil me një shtetas italian, i përfaqësuar në Shqipëri nga shtetasi E.B, babai i prokurorit të Prokurorisë Tiranë, Endrit Bimi. Me anë të kësaj letrë ai ankohet se veprimet e kryera nga policia e Durrësit, në datën 11 qershor 2011, që kanë të bëjnë me kërkimin prej tyre të një automjeti me targa TR \*\*\* J, i cili është në pronësinë e ankuesit, si dhe interesimi për vendndodhjen e apartamentit të ankuesit, sipas tij kanë të bëjnë me veprimet e paligjshme të prokurorit Endrit Bimi. Kjo sepse babai i tij ka një konflikt civil me ankuesin dhe prokurori, duke shfrytëzuar postin e tij, i ka kërkuar policisë kryerja e këtyre veprimeve. Prokuroria e Përgjithshme ka pyetur punonjësit e policisë që kanë kryer veprime dhe ka rezultuar se veprimet e tyre nuk kanë pasur lidhje me ndërhyrje nga prokurori Endrit Bimi. Me shkresën nr. \*\*\*, datë 26.9.2012, ankuesve u është kthyer përgjigje se nga verifikimet e kryera nuk rezultojnë elemente që të bëjnë shkak për fillimin e procedimit disiplinor ndaj prokurorit Endrit Bimi.

Më pas, ky shtetas ankohet në Prokurorinë e Përgjithshme, ankesë e protokolluar me nr. \*\*\*, datë 7.3.2013, në të cilën ankohet se kallëzimi i tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është mosfilluar dhe, sipas tij, në mënyrë të padrejtë. Me shkresën nr. \*\*\*, datë 15.5.2013, Prokuroria e Përgjithshme njofton ankuesin se pas verifikimeve nuk rezultoi se nga ana e prokurorit janë lejuar shkelje të ligjit material dhe procedural në marrjen e vendimit të mosfillimit, datë 15.4.2013.

## **ii. Ankesa e shtetasve A. M dhe A.K**

Në Prokurorinë e Përgjithshme është depozituar një ankesë nga shtetasit A. M dhe A.K, me detyrë inspektorë të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar Tiranë, të cilët pretendojnë se janë marrë padrejtësisht nën akuzë për shpërdorim detyre nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me kallëzimin penal të bërë ndaj tyre nga shtetasi N.L. Ky procedim penal, sipas ankuesve, ndiqet nga prokurori Endrit Bimi. Prokuroria e Përgjithshme e ka dërguar këtë ankesë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për ndjekje.

**iii.** Kallëzim penal nga shtetasi A.B ndaj z. Endrit Bimi, me detyrë prokuror, dhe shtetasi A. P me detyrë oficer i policisë gjyqësore, të dy në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky kallëzim penal është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe është trajtuar tek pjesa e kallëzimeve penale.

## **44. ANALIZA E GJETJEVE**

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; si dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

### **1. Aftësitë profesionale**

#### *a) Njohuritë ligjore*

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se subjekti, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit.

Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret. Kështu, menjëherë pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre.

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme.

#### *b) Arsyetimi ligjor*

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara evidentohet se ai shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore. Arsyetimin ligjor e mbështet jo vetëm në normat penale, por edhe në normat sipas specifikave të hetimeve që ka kryer, në ligjet që normojnë fushën e tatim-taksave, kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe në ligje të tjera specifike.

## **2. Aftësitë organizative**

### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti në formularin e vetëdeklarimit rezulton se për periudhën e punës si prokuror, subjekti ka trajtuar 487 çështje.

Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura, rezulton se subjekti tregon vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara.

Subjekti ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe numrit total në çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit, duke specifikuar se për periudhën e vlerësimit ka qenë pjesë e Njësisë së Përbashkët Hetimore kundër Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, procedime penale që nga natyra e tyre kërkojnë një kohë të gjatë për zgjidhjen e tyre.

### *b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore*

Subjekti i rivlerësimit kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga ana e tij veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve, konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve.

### *c) Aftësia për të administruar dosjet*

Subjekti ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimin. Aktet janë ndarë me paragrafë të numërtuara sipas specifikës së përmbajtjes së trajtuar për çdo paragraf.

## **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

### *a) Etika në punë*

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

### *b) Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

### *c) Paanësia*

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e rëna në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

#### 4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

##### a) Aftësitë e komunikimit

Nga 3 dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

##### b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

##### c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, subjekti rezulton se gjatë kohës së rivlerësimit dhe më parë ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

#### Denoncimet e publikut të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

45. Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 12 denoncime të paraqitura në Komision, ku pas shqyrtimit të tyre i janë kërkuar shpjegime për 3 denoncimet e mëposhtme:

##### 1. Denoncim i shtetases M. D<sup>61</sup>

Denoncuesja ankohet për tre subjekte rivlerësimi, përfshirë edhe subjektin Endrit Bimi. Ajo pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetimet e nevojshme për çështjen penale për të cilën ka paraqitur kallëzim penal dhe ka vendosur në mënyrë të padrejtë mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin nr. \*\*\* për veprën penale “shpërdorim detyre” nga punonjësit e IMT-së, Bashkia Tiranë.

Nga dokumentacioni shoqërues i denoncimit rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2016 dhe ndaj këtij vendimi subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Subjektit iu kërkuar shpjegime lidhur me veprimet hetimore të kryera për këtë procedim, si dhe depozitim të dokumentacionit përkatës.

Në shpjegimet e tij, subjekti ka deklaruar: *“Në lidhje me çështjen në fjalë janë kryer këto veprime: është marrë deklaram nga shtetasi L.K, me detyrë inspektor në IMT pranë Bashkisë Tiranë, si person që ka kryer veprimet ekzekutive të kundërshtuara nga kallëzuesja; janë marrë me procesverbal të gjitha aktet që i përkasin praktikës ku janë mbështetur veprimet e kundërshtuara nga kallëzuesja, që janë shkresa nr. \*\*\*, datë 23.2.2016, shkresa nr. \*\*\*, datë 12.4.2016, informacion datë 19.4.2016, së bashku me dy foto, informacion datë 28.4.2014, relacion datë 29.4.2016, procesverbal datë 28.4.2016, vendim prishje nr. \*\*\*, datë 29.4.2016, vendim juristi datë 29.4.2016, procesverbal datë 30.4.2016, informacion datë 28.4.2016, shkresë nr. \*\*\*, datë 25.5.2016 dhe procesverbal datë 8.6.2016, për marrje në dorëzim. Në vijim, oficeri i policisë gjyqësore më ka informuar me shkrim mbi rezultatet e materialit të çështjes dhe për mënyrën e përfundimit të saj, me mosfillim të procedimit.*

*Në këto kushte, duke qenë e mjaftueshme për vlerësim baza dokumentare e administruar që i përkiste praktikës së punës ku ndodhej e gjithë veprimtaria e kundërshtuar nga kallëzuesja, është proceduar me vendim për mosfillimin e çështjes. Mbi bazën e ankimit të kallëzueses, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 24.2.2017, ka shfuqizuar vendimin e mosfillimit, duke urdhëruar vazhdimin e kryerjes së veprimeve hetimore, vendim i*

<sup>61</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2017.

*cili është ankimuar. Nga vërtetimi datë 19.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se çështja ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit pa një vendimmarrje në lidhje me të”.*

Në mbështetje të shpjegimeve të mësipërme, subjekti ka paraqitur aktet e mëposhtme:

- dosjen e kallëzimit penal nr. \*\*\*/viti 2016;
- kopje të ankimit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ndaj vendimit nr. \*\*\* akti, datë 24.2.2017;
- vërtetimin datë 19.10.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit vendimi nr. \*\*\* akti, datë 24.2.2017, i Dhomës Penale të kësaj gjykate është ankimuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë – sipas këtij vërtetimi, aktualisht dosja penale ndodhet në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe nga kjo gjykatë nuk ka informacion nëse ka vendimmarrje lidhur me këtë çështje.

Në përfundim, pas analizimit të fashikullit hetimor dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni, me shumicë votash, vlerëson se ai ka ndjekur të gjitha hapat procedurale të nevojshme.

## **2. Denoncime të shtetasit A.Z<sup>62</sup>**

Denoncuesi ankohet për disa subjekte rivlerësimi, përfshirë edhe subjektin Endrit Bimi. Në lidhje me subjektin ai pretendon se gjatë hetimit të procedimit penal, të regjistruar më 9.1.2018, subjekti ka kryer shkelje të rënda procedurale, të cilat lidhen me tejkalimin e afatit procedural për kryerjen e hetimeve paraprake.

Komisioni administroi dosjen e procedimit penal, nga e cila rezultoi se mbi bazë të kallëzimit të denoncuesit, prokuroria ka regjistruar procedimin penal në datën 9.1.2018. Kallëzuesi pretendon se në përpilimin e një kontrate qiraje noteri A. R ka falsifikuar emrat e listës së bashkëpronarëve, duke konsumuar kështu veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal.

Sipas materialeve të dosjes hetimore rezulton se:

- Procedimi penal është regjistruar në datën 9.1.2018 dhe mbi bazën e vendimit “mbi zëvendësimin e prokurorit”, datë 21.2.2018, dosja hetimore i është caktuar në ndjekje subjektit të rivlerësimit Endrit Bimi.
- Në datën 12.7.2018 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në gjykatë “kërkesë për pushimin e çështjes”, duke argumentuar se në këtë material kallëzuesi ka paraqitur të njëjtat fakte dhe rrethana të shqyrtuara në kallëzimin penal nr. \*\*\*, për të cilin është vendosur “mosfillimi i procedimit penal”.

Subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me arsyen përse ka kërkuar pushimin e çështjes rreth 5 muaj pas marrjes në ngarkim të procedimit penal, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka kryer asnjë veprim hetimor.

Në shpjegimet e tij, subjekti ka deklaruar: *“Afati i hetimeve paraprake përfshin dy momente: në momentin që çështja është pa autor afati i hetimeve është i barabartë me afatet e ndjekjes penale dhe përfundon sipas përcaktimeve të nenit 66 të Kodit Penal, që titullohet parashkrimi i ndjekjes penale, ku përcaktohen afatet e parashkrimit për çdo vepër penale nisur nga masa e dënimit të tyre (këto afate fillojnë nga tre vjet për kundërvajtjet penale që dënohen deri në dy vjet burgim, e vijë duke u shtuar për krimet, sipas masës së dënimit).*

<sup>62</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 22.4.2021; nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2019.



*Ndërsa, kur çështja është me autor për shkak të detyrimit të respektimit të të drejtave të njeriut respektohen afatet e nenit 323/2 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin përcaktohet se afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilin është regjistruar emri i personit. Për këtë arsye, neni 323/1 thotë: ‘Brenda përfundimit të afatit ligjor të hetimeve prokurori vendos sipas pikës 6 të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, ku vendimmarrja është ose pushim akuze/çështje ose dërgim në gjyq.*

*Pezullimi i hetimeve (pra çështje pa autor) sanksionohet në nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale, ku duket qartë që prokurori nuk ka asnjë obligim me afatet, përveçse afateve të parashkrimit të ndjekjes penale (neni 66 i Kodit Penal). Hetimi i çështjes pa autor është i barazvlefshëm me pezullimin e çështjes, për sa i përket afateve. Pavarësisht kësaj analize, organi akuzës hetimet nuk i kryen duke i zgjatur ato deri në afatet e parashkrimit, por vonesat në hetime, si dhe për rastin në fjalë vijon edhe si pasojë e ngarkesës në punë që ka gjithë stafi i prokurorisë (prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore dhe sekretari)”.*

Në përfundim, pas analizimit të fashikullit hetimor dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se vonesat në hetim dhe vendimmarrje nuk mund të justifikohen me ngarkesën e lartë të punës në këtë institucion. Por, kjo vonesë në vendimmarrje e subjektit të rivlerësimit nuk mund të konsiderohet si mangësi profesionale, që mund të çojë në marrjen masës disiplinore.

### **3. Denoncim i shtetasit A.L<sup>63</sup>**

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka bërë klasifikim të gabuar të veprës penale, në procedimin penal nr. \*\*\*, datë 14.10.2014, në ngarkim të tij dhe të babait, në cilësinë e të pandehurve. Denoncuesi sqaron se ai dhe i ati kanë pasur një konflikt fizik me shtetasin I.H, përfaqësues i palës me të cilin kishin procese gjyqësore të vazhdueshme. Konflikti ka ndodhur në ambientet e gjykatës dhe mbi bazë të tij ka filluar procedimi penal në ngarkim të denoncuesit dhe babait të tij.

Sipas tij, subjekti ka ngritur në mënyrë abuzive akuzën për kryerjen e veprës penale “kundërshtim dhe goditje e gjyqtarit”, të parashikuar në nenet 316 dhe 25 të Kodit Penal, pasi personi me të cilin denoncuesi dhe i ati i tij janë konfliktuar nuk ka statusin e posaçëm të përcaktuar në nenin 316 të Kodit Penal.

Nga materialet bashkëlidhur denoncimit, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve dhe ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Komisioni administroi dosjen e procedimit penal, nga e cila rezultoi se në fashikullin hetimor është administruar, ndër të tjera:

- Prokura e posaçme nr. \*\*\*, datë 10.5.2014, përmes së cilës shtetasi I.H ka përfaqësuar në gjykim palën ndërgjyqësore L. L. Sipas përmbajtjes së kësaj prokure rezulton se shtetasi I.H ka përfaqësuar palën paditëse në gjykim, në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë, por jo në cilësinë e avokatit, në kuptim të ligjit nr. 9109, datë 17.7.2003, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.
- Shkresa datë 14.5.2014, e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, ku citohet: “Avokati në fjalë nuk gëzon të drejtën ligjore të ushtrimit të profesionit të avokatit”.

Subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me arsyen e ngritjes së akuzës për veprën penale të parashikuar nga neni 316 i Kodit Penal, ndërkohë që përfaqësuesi i palës paditëse në gjykimin civil nuk ka pasur statusin e subjekteve të mbrojtur nga neni 316 i Kodit Penal, ku në mënyrë

---

<sup>63</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2019.

specifike janë evidentuar gjyqtari, prokurori, avokati, eksperti dhe çdo arbitër i caktuar për një çështje.

Në shpjegimet e tij, subjekti ka deklaruar: “Denoncuesit, Y dhe A.L, e kanë goditur z. I.H në ambientet e gjykatës, për shkak të detyrës së avokatit që ai kryente. Atë ditë ai (I.H) përfaqësonte duke mbrojtur palën kundërshtare të denoncuesve. Arsye tjetër nuk ka si të ketë, nëse do kishte arsye tjetër ajo do të kishte ndodhur të paktën në një kohë tjetër, por gjithsesi asnjëherë direkt pas seancës [...]. Po të shikohet formulimi i nenit 316 kuptohet qartë se qëllimi i legjislatorit është t’i ofrojë pjesëmarrësve në proces garanci e mbrojtje të posaçme ligjore nga çdo veprim i kundërligjshëm si rrjedhojë e veprimitarisë së tyre në proces. Denoncuesit, z. H, nga ana subjektive e kanë goditur në cilësinë e avokatit të kundërshtarit të tyre.

Objektivisht, në kuptim të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile – në të cilin parashikohet se përfaqësues të palëve në proces mund të jenë: a) avokatët [...] e të tjerë – avokati dhe përfaqësuesi me prokurë barazohen për nga të drejtat dhe detyrimet. Ata kanë të njëjtat detyrime si kundrejt gjykatës, klientit të tyre dhe palës tjetër dhe anasjelltas. Nëse nuk do të ishin këto të drejta e detyrime, vetiu do të rrëzohej një parim shumë i rëndësishëm, solemniteti procesit gjyqësor.

Të tilla të drejta dhe detyrime vijnë edhe pas daljes nga seanca, duke u garantuar përfaqësuesve/avokatëve paprekshmërinë e tërësisë trupore, qetësinë për të kryer detyrën e tyre në përputhje me ligjet dhe normat e gjithëpranuara morale, juridike apo dhe zakonore si dhe veprimitarinë e aktorëve të drejtësisë. Znj. L shtetasin I.H e prezanton si avokatin e saj (shiko deklarin e saj në f. 5 dhe f. 6 të vendimit nr. \*\*\*, datë 1.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë). Denoncuesit e njohin dhe e thërrasin z. H si avokatin e znj. L (shiko deklarin e z. Y.L në f. 7 të vendimit nr. \*\*\*, datë 1.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë). Imazhi dhe opinioni publik për shtetasin I.H është që ai ushtron detyrën e avokatit (në f. 24 dhe 47 të fashikullit hetimor ndodhen dy kartonët me numër licence \*\*\*, ku konfirmohet se shtetasi I.H ka titullin avokat, ku në njërin prej tyre përcaktohet afati i vlefshmërisë deri më 31.1.2015, të lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë të Shqipërisë”).

Në mbështetje të shpjegimeve të mësipërme, subjekti ka paraqitur aktet e mëposhtme, të cilat janë shkëputur nga dosja hetimore:

- kopje të kartës së anëtarësisë së shtetasit I. H pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë;
- kopje të licencës së ushtrimit të profesionit të avokatit të shtetasit I.H;
- shkresë e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në përmbajtje të së cilës konfirmohet se shtetasi I.H është anëtar i Dhomës së Avokatisë Durrës, me licence nr. \*\*\*, me detyrime të pashlyera prej vitit 2006 e në vazhdim.

Në përfundim, pas analizimit të fashikullit hetimor dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë konstatim nuk janë bindëse, por veprimet e tij nuk mund të klasifikohen si mangësi profesionale, për sa kohë kanë të bëjnë me bindjen e brendshme të tij.

#### **4. Denoncim i shtetasës H. B<sup>64</sup>**

Në datën e zhvillimit të seancës dëgjimore ndaj subjektit të rivlerësimit, pranë Komisionit u depozitua një denoncim rishtazi nga shtetasja H. B. Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit, në bashkëpunim me zyrën përmbartimore “A” sh.p.k., kanë kryer shitjen në ankand të banesës së saj, duke kryer veprime të kundërligjshme. Denoncuesja gjithashtu pretendon se subjekti i rivlerësimit ka ndërtuar një shtesë pa leje në pallatin ku ai banon, si dhe ngre dyshime mbi ligjshmërinë e të ardhurave të subjektit, të cilat sipas denoncueses, i ka përdorur për të investuar në hapjen e një klinike të re dentare për bashkëjetuesen e tij.

<sup>64</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2021.

Në lidhje me këtë denoncim, trupi gjykues, pasi analizoi denoncimin, vendosi të mos riçelë hetimin, mbështetur në faktin se ai ishte trajtuar më parë, si dhe denoncuesja nuk ka paraqitur prova për të provuar pretendimet në lidhje me faktin se në banesën e babait të subjektit, përfituar me trashëgimi, kishte një shtesë, por edhe në lidhje me faktin se subjekti i kishte hapur një klinikë private stomatologjie bashkëjetueses së tij në Rrugën e Elbasanit. Komisioni, në lidhje me këtë pretendim të denoncueses, verifikoi ekstraktin e thjeshtë dhe historik të regjistrit tregtar për të dhënat e bashkëjetueses së subjektit në QKB, nga ku rezultoi se vendi i ushtrimit të aktivitetit nuk kishte ndryshuar, duke qenë po i njëjti në rrugën “Mine Peza”, që i është nënshtruar hetimit dhe analizës më sipër.

### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

**46.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

**46.1.** Shumica vlerëson se konstatimet në lidhje me denoncimet 2 dhe 3 nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në gerrat “b” dhe “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016. Këto konstatime nuk mund të konsiderohen si mangësi apo cilësi të papranueshme në punë apo gjykim i dobët, që të sjellin lindjen e nevojës për program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës apo shkarkimin nga detyra si të papërshtatshëm.

Shumica vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

**46.2.** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **V. KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- i. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; dhe:
- iii. subjekti e arrin nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Endrit Bimi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 3.11.2021.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Alma FASKAJ**  
**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Anëtar**  
**(kundër)**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*